

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7431 E hënë 5 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**Nga të paktën një kënd, në një nga deklaratat e opozitës përpara protestës, mikrofonat vënë përpara kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha zinin thujtaje...**

*Vijon në faqen 20*

**Opinion** **Ditës**

**Nga JULIAN ZYLA**

**Çfarë mund të humbasë LSI nga aleanca me PD**



**Opinion** **Ditës**

**Nga SHABAN MURATI**

**Sovraniteti apo integrimi europian**

**Një burim i mirinformuar diplomatik bën të ditur se Holanda i ka paraqitur një kusht Shqipërisë, që do t'ia japë votën për hapjen e bisedimeve të pranimit me BE-në...**

*Vijon në faqen 21*



Mbeten në burg Dashamir Xhika dhe Andi Toma, debatet në gjyq

## Skandali me rrugën Tiranë-Elbasan, në pranga edhe dy ish-zyrtarë të tjerë

Aksel Qurduku dhe Alben Alite, ish-drejtuës në Njësinë së Menaxhimit akuzohen për korrupsion

Nga INA ALLKANJARI

**P**riten dy fletarreste të tjera pas prangosjes së dy ish-drejtorëve të "Rrugëve". Dashamir Xhika dhe Andi Toma. Aksel Qurduku dhe Alben Alite, ish-drejtuës në Njësinë së Menaxhimit të projektit Tiranë-Elbasan do të gjykojnë për shpërdorim detyre e korrupsion...

*Në faqen 7*

## SHQIPERIA NEN 'PUSHTETIN' E UJIT, SHEMBEN 4 URA, IZOLOHEN 100 SHTEPI NE SHIJAK

# PERMBYTJET NE JUG, EVAKUOHEN 21 FAMILJE

Prokuroria nis hetimet për pallatin 8-katësh që rrezikon shembjen. Dëshmitë, banorët: Na ka rënë balta në kokë, e kemi gdhirë jashtë



(Në foto) Banesa të demtuara nga përmbytjet. Rruga e shkatërruar në Gjirokastër

### PARALAJMERIMI

**Protestat e reja të opozitës më 20 shkurt dhe 22 mars, detajet se çfarë do të ndodhë**

*Në faqen 5*

### NGA TAHIRI, TE VOTA KUNDRA

**Majko në SHBA me emigrantët, pyetjet që e vunë në siklet ministrin e Diasporës**

*Në faqen 4*

### DESHMIA E RE

**Rindërtohet skema e vrasjes së Devi Kasmit, Malvin Dinellari: Lidhja me vëllezërit e grekun**

*Në faqen 9*

### DROGE EDHE NE LEZHE

**Kurbin, qëllimi me armë në ajër dhe kërcënohi shokët e punës, arrestohet 21-vjeçari**

*Në faqen 6*

**SPAHIU: ALARM, 7 MIJE RASTE KANCERI NE VIT**



**Orges Spahiu:**

**Mjeku popullor Merja: Si të shkrihi gurët në veshka me bimët mjekësore pa operacion**

Suplement

Misioni i Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara raporton për Lec Shllakun

## Betejë për sheshin "Skënderbej" në Paris, kabllogramet

Përplasjet e të arratisurve dhe qeverisë së Enver Hoxhës në vitin 1978

Nga YLLI POLOVINA

**M**e radiogramin e koduar "Tepër sekret" dhe numër 3387 të datës 26 tetor 1978 drejtuesi i Misionit të Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në Nju Jork njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë



se "Gazeta 'Liria' boton një letër të Lec Shllakut që thotë se ka siguruar nga bashkia e Parisit autorizimin që një sheshi t'i vihet emri 'Skënderbeu' dhe se për këtë do bëhet një ceremoni". Shtonte më pas: "Leci, me sa dimë, është i arratisur"...

*Në faqen 10-11*

## MOTI I KEQ PERMBYTJET

### ÇERMË E SIPËRME, DIVJAKË, POLICIA SHPËTON 10 PERSONA

Policia në Divjakë ka mundur të evakuojë një familje me 10 anëtarë, e cila kishte mbetur e bllokuar nga uji. Evakuimi i familjes është bërë fshatin Çermë e Sipërme në Divjakë. "Falë ndërhyrjes së shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Divjakë, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe administratën e zonave të mbrojtura, u bë e mundur që në fshatin Çermë e Sipërme, të evakuohej familja prej 10 anëtarësh dhe dërgimi i tyre në një ambient të sigurt", thotë policia. Gjithashtu u evakuua edhe bagëtia dhe gjëja e gjallë e kësaj familjeje.



### FSHATI NOVOSELË


#### EVAKUOHEN 70 FAMILJE

Në fshatin Fitore e Novoselë të Vlorës, Emergjencat Civile dhe ushtria bënë evakuimin e banorëve, shtëpitë e të cilëve ndodhen në shtratin e lumit. Në Novoselë mbrëmjen e djeshme është bërë evakuimi i 70 familjeve, ku një pjesë e tyre janë strehuar te të afërmit, ndërsa pjesa tjetër ka zgjedhur të qëndrojë në katet e dyta të banesave të tyre. Ndërkaq, banorët kanë bërë thirrje për largimin e bagëtive, pasi rreziku që të ngordhin është tejet i lartë. Ndërkaq, Shtabi i Emergjencave theksoi se prurjet do të vijojnë të jenë të larta. Më tej, kreu i Bashkisë së Vlorës, Dritan Leli theksoi se në gatishmëri është pushteti vendor dhe ushtria.

PËRMBYTJET / 100 banesa të izoluar në Shijak, shemben 4 ura në Korçë, Gjirokastrë e Librazhd

# Moti i keq, Shqipëria nën "pushtetin" e ujit

Evakuohen mbi 100 familje në mbarë vendin



Uji ka depërtuar brenda në banesa



Voltiza Duro

Reshjet e dendura të shiut përgjatë të shatërnës kanë shkaktuar përmbytje e dëme të shumta materiale në shumë qytete të vendit veçanërisht në Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Elbasan, Dibër, Lezhë e Kukës. Pasditën e së djeshmes, prurjet e lumit Vjosë kanë arritur në nivelin 8 metra, ku në Fier u përshkrua nga uji fshati Ferras, në një kohë që në fshatrat Çerven dhe Kashisht uji ka arritur në dyert e banesave, por fatmirësisht nuk ka mundur t'i përmbytë. Për arsye sigurie familjet e rrezikuara u evakuuan duke u strehuar tek të afërmit. Në këto zona, qindra hektarë tokë kanë përfunduar nën ujë duke shkaktuar kështu dëme të mëdha në kulturat bujqësore të fermerëve. Ndërsa në fshatin Fitore e Novoselë të Vlorës, Emergjencat Civile dhe Ushtria bënë evakuimin e banorëve, shtëpitë e të cilëve ndodhen në shtratin e lumit. Në Novoselë mbrëmjen e djeshme është bërë evakuimi i 70 familjeve, ku një pjesë e tyre janë strehuar te të afërmit, ndërsa pjesa tjetër ka zgjedhur të qëndrojë në katet e dyta të banesave të tyre. Ndërkaq, banorët kanë bërë thirrje për largimin e bagëtive, pasi rreziku që të ngordhin është



Ura e përmbytur nga rreshjet e shiut

të tejet i lartë. Paraditen e të dielës përmbytjet përfshinë edhe Librazhdin, Elbasanin, Peqinin, Rogozhinën e Myzeqenë. Si pasojë e vërshimit të lumit Shkumbin, ura e Rrethit të Bardhë në njësinë administrative Hotolish në Librazhd është shembur plotësisht, si dhe janë vënë nën "pushtetin" e ujit fshatrat Zdrash, Verri dhe Orenjë. Sakaq, janë konstatuar probleme edhe në qarkullimin e automjeteve në aksin Librazhd-Përrenjas si pasojë e rënies së gurëve

nga shpatet e maleve, veçanërisht në zonën e quajtur "Kthesat e Murrashit". Edhe katet e para të shumë banesave në Librazhd janë përmbytur nga uji, ndërsa në Fushë-Krujë niveli i lumit Ishëm është rritur së tepërmi e ka rrethuar shtëpitë e banorëve të zonës. Sipas të dhënave, në fshatrat Murqin Bilaj, Mazhë e madhe e Mazhë e vogël, mbi 500 hektarë tokë kanë përfunduar nën ujë. Moti i keq dhe reshjet e dendura të shiut kanë krijuar shumë prob-

leme edhe në qarkun e Korçës, ku si pasojë e vërshimeve të mëdha të ujit janë dëmtuar dy ura, ajo e fshatit Arrëz në Devoll që ka pësuar dëme të konsiderueshme si dhe ura e Orgockës në Kolonjë, e cila është edhe monument kulture. Kjo e fundit lidh 4 fshatra të Kolonjës, Radovicke, Qinanam, Kurtesh dhe Orgockë me 3 fshatra të Përmetit Frashër, Vërçisht dhe Koblarë. Por, edhe në zonën e Burrelit disa godina rrezojnë në shembjen për shkak të shkarjeve të dheu, në një kohë që Policia e Shtetit kaloi në gatishmëri të përforcuar për t'i ardhur në ndihmë banorëve. Sipas raportit të Emergjencave Civile, akset kombëtare janë të kalueshme, por në aksin rrugor Tepelenë-Gjirokastrë ka vështirësi qarkullimi. Edhe akset Tiranë-Dajt, Mamurras-Ura e Drojës, Krujë-Qafë Shtamë, Rrapës të Pukës, Klos-Bulqizë, Vanë të Delvinës dhe në aksin Kuç-Vlorë paraqiten problematika në qarkullimin e automjeteve. Reshjet e dendura të shiut kanë përmbytur dhjetëra shtëpi edhe në Shijak, ku lumi ka dalë nga shtrati e ka "pushtuar" katet e para të rreth 100 banesave që qëndrojnë në këtë situatë pa dritë e pa ujë, prej më shumë se 24 orësh. Ndërkaq, Forcat e Armatosura kanë përfunduar operacionin e kërkim shpëtim në Zall-Bastar, ku u evakuuan nga njëri breg i lumit në tjetrin 15 banorë, ndërsa u nxor nga lumi furgoni që kishte mbetur në rrjedhën e ujit.

### Policia e Shtetit në gatishmëri

## IGJEUM: Sot përmirësime moti, situata normalizohet

Sipas llogaritjeve hidrologjike të Institutit të Gjeoshkencave parashikohet se prurjet e lumit Vjosa do të ishin kritike përgjatë ditës së djeshme dhe do të kthehet brenda shtrati natyral ditën e sotme. Dje, në qarqet Fier dhe Vlorë është vendosur ngjyra e kuqe, si niveli i lartë i rrezikut për efekt të përmbytjeve dhe jo të reshjeve. "Sot pasdite (e diel, dt.04) priten reshje, por lokale dhe të dobëta, ndërsa nesër (e hënë, dt.05) nuk priten reshje. Reshjet do të jenë në formën e dëborës 500 metra mbi nivelin e detit, ndërsa në Verilindje në zona të kufizuara edhe më poshtë se ky nivel". - bëri me dije dje IGJEUM. Gjatë orëve të shkuara, në të gjithë vendin ka pasur reshje të dendura të shiut, ku me intensitet më i lartë u regjistrua Kukës, Vlorë e Gjirokastrë. Brenda një kohe shumë të shkurtër niveli i prurjeve të Lumit Vjosë në Memaliaj arriti vlerën e 8 metrave nga 1-1.5 që ishte përpara fillimit të reshjeve. Gjatë natës së të shtunës, nga pjesëtarët të Forcave të Armatosura, të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera të janë kryer ndërhyrje për evakuimin e njerëzve dhe të gjëse së gjallë në qarqet e Fierit, Vlorës Gjirokastrës. Reshjet kanë krijuar probleme edhe në qarqe të tjera të vendit si Kruja, Tirana, Elbasani, Dibra, Lezha dhe Kukësi. Në Zall Bastar të Tiranës janë shpëtur pasagjerët e një furgoni dhe një veturë që kishte mbetur në mes të lumit. Në lagjen "Kodra e Shtufit" në Gjirokastrë u krye evakuimin i banorëve të një pallati të rrezikuar nga rrëshqitjet e dheut.





**FIER E VLORË**

**FA EVAKUOJNË 2 GRA DHE 2 FËMIJË**

Forcat e Armatosura bënë evakuimin e një gruaje bashkë me dy fëmijët e saj në Levan të Fierit. Si pasojë e përmbytjeve, ata ishin bllokuar në banesë për dy orë me radhë. Evakuimi u bë me një gomone të ushtrisë. Ndërkohë, helikopteri i Ministrisë së Shëndetësisë ka shpëtuar një grua që kishte mbetur e bllokuar për 4 orë nga rrjedha e lumit në Nesarak të Armentit në Vlorë, e cila më pas është dërguar në "QSUT" në Tiranë për ndihmë mjekësore. Ekipi i mjekëve të Njësisë së Helikopterëve i dhanë ndihmën e parë, duke e nxjerrë nga rreziku për jetën. Në gatishmëri janë edhe autoambulancat, të cilat transportuan drejt spitalit të Vlorës disa banorë të evakuuar nga zonat e përmbytura.



**GJIROKASTËR**

**SHEMBET URA HISTORIKE E HOSHTEVES NE ZAGORI**

Ura historike e gurtë e Hoshtevës rrezohet si pasojë e fryrjes së lumit nga përmbytjet e fundit. Lajmin e bëri ditur urbanisti Besnik Aliaj, i cili shkruan: "Para një muaji ngrita zërin dhe bëra alarm dy herë bashkë me disa banorë të zonës! Të ndërhyhet me emergjencë për të forcuar bazamentin, më pas të bëhej rikonstrukcioni. Nga përvoja ime dhe e ekspertëve, shirat e radhës do ishin fatale. Por, për fat keq qeveria vendore, rajonale dhe qendrore më injoruan! Dikush fatkeqësisht mendoi se e bëra për politikë. Ndërkohë, ministria e linjës dhe ekspertët rajonalë të saj çuditërisht dhanë garanci se ura nuk ka shans të shembet!"



Pas motit të keq e reshjeve të dendura të shiut, Gjirokastra është një prej qyteteve më të prekura ku banorët ende janë në panik për shkak të gjendjes së rënduar në të cilën ndodhen. Masivi i dheut që u shkëput shkatërroi rrugën totalisht e zbarkoi në banesat e familjeve të një pallati 8-katësh. Me lot në sy, një prej banoreve të prekura tregon banesën e mbuluar nga dheu e uji e më tej shton se do të ishte më mirë të kishte vdekur sesa të përjetonte këtë situatë, e cila i kapi papritur teksa po flin

**"Jemi të dy me kimioterapi, na shkatërroi totalisht"**

**Banorja gjirokastrite rrëfen tmerrin e "zaptimit" të shtëpisë nga masivi i dheut**



Banorja duke folur për rrëshqitjet e dheut

nin gjumë. Gruaja rreth të 50-ve, me këmbët në ujë shton se vetë ajo dhe i shoqi rreth të 60-ve trajtohen me kimioterapi e tashmë është shkatërruar çdo gjë, pasi kjo shtëpi ishte bërë me punën e gjithë jetës së tyre. "E dua shtëpinë ashtu siç e kisha, në vend me të gjitha. Pse e ndërtauan pallatin kur nuk duhej ndërtaur, në të kundërt do të shkoj të rri në shtëpitë e këtyre që na bënë

këtë dëm. Nuk kishte arsye pse të përmbytej, nuk jemi në luftë. Edhe luftë të ketë, dëmi nuk mund të jetë kaq i madh. Çfarë ishte kjo që na ndodhi, na vrau me kokë e më këmbë, na hëngri të gjallë, më mirë të kisha vdekur mbremë", - shprehet e revoltuar banorja, ndërkohë që tregon masivin e madh të dheut që i ka zaptuar shtëpinë.

Pallati 8-katësh rrezikon shembjen nga përmbytjet, evakuohen 21 familje. Prokuroria nis hetimet

# Reshjet e dendura të shiut, panik në Gjirokastrë

Shefi i Shtabit të Ushtrisë: 200 forca të FA-së në Fier e Vlorë, dy zonat më të prekura nga përmbytjet

Si pasojë e reshjeve të dendura të së shtunës, masivë të mëdha dheu kanë zaptuar banesat e katëve të para e të dyta në një pallat tetëkatësh në lagjen "Kodra e Shtufit" në Gjirokastrë, duke dëmtuar rëndë shtëpitë. Në vetëm pak kohë, balta ka arritur të depërtojë brenda banesave duke i bërë ato të pabanueshme. Rrëshqitja e dheut ndodhi mbrëmjen e së shtunës si pasojë e reshjeve të pandërprera të shiut për më shumë se 48 orë. Policia ka bërë evakuimin e menjëherëshëm të banorëve dhe sigurimin e zonës, ndërsa banorët janë rikthyer mëngjesin e djeshëm në shtëpitë e tyre. Masivi i dheut që përmbyti pallatin ka shembur edhe një pjesë të rrugës



Masivi i dheut ka zaptuar banesat

së sipërme, duke shkatërruar totalisht asfaltin. Në rrezik gjenden edhe tri vila private në pjesën e sipërme të

kësaj kodre. Bashkia e Gjirokastrës i ka drejtuar një kërkesë Drejtorisë së Emergjencave Civile për një

grup vlerësimi në lidhje me situatën. Banorët gjirokastritë të revoltuar tregojnë se balta u ka rënë në kokë e

**SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FA, BARDHYL KOLLÇAKU**

"FA në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Delta Forcë dhe FNSH kanë evakuuar një familje me 7 anëtarë që ishin të bllokuar në Ferras, po ashtu edhe një i sëmurë që është transportuar për në spitalin e Fierit. Janë mbi 200 Forca të Armatosura të dislokuara në Fier dhe Vlorë, si dhe mbi 800 forca të gatshme nëpër reparte në gjithë Shqipërinë. Gjatë gjithë ditës janë evakuuar familje të tëra, gjëja e gjallë por edhe orëndi shtëpiake në zonat që parashikohet të ndodhin përmbytje".

janë detyruar të gdhijnë natën jashtë.

**SHKRESA**

Kryebashkiakja e Gjirokastrës, Zamira Rami, në një shkresë drejtuar kryeministrit Edi Rama ka kërkuar shpalljen e gjendjes së emergjencës, pasi gjendja e krijuar nuk mund të përballohet nga pushteti vendor. Për këtë arsye, kryebashkiakja Rami kërkon ndërhyrjen e pushtetit qendror. Rami më shkresën drejtuar Ramës bën një pasqyrim të situatës së rrëshqitjeve të dheut në tri lagje, "Kodra e Shtufit" ku

një pallat është zaptuar nga balta dhe dy banesa private rrezikojnë shembjen, në "Çfakë" dhe lagjen "Punëtori", ku sërish paraqiten probleme me banesat. Ndërkohë, për banorët është dhënë urdhri i menjëherëshëm i evakuimit. Përveç problemeve të shumta brenda në qytet, shkresa zyrtare jep një panoramë të të gjitha problematikave në Bashkinë Gjirokastrë, ku disa fshatra janë izoluar nga përmbytjet dhe nga shembja e urave, ndërsa akset kryesore rrugore kanë probleme me qarkullimin.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"**  
me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Dt 05.02.2018 ora 16:00  
Përfundon Ankandi i Tretë për pasurinë:  
"Pasuria "Apartamenti" me sip. 55 m2, Nr. pasurie 212/15+1-5, Z. K 2140, Vol. 2, Fq. 33, me adresë Kërcukal (Gosë), Kavajë. Me çmim i 247 400 Lekë

Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria),Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
Zyra përmbareme "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 12 shkurt 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përmbareme do zhvillohet ankandi i re për shënjën e tre parcelave të ndodhura në L.13, ZK 8518, Pllazh, Durrës e konkretisht pasuritë nr 5854, vol 17, fq 2, 5856, fq 3, 5857, fq 4. Cdo truall ka sipërfaqen prej 400 m<sup>2</sup> dhe mbi të rrezon një matrovëzje sipërmerje.

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do jetë:

1) për pasurinë 5854 është 570000 Euro; 2) për pasurinë 5856 është 570000 Euro; 3) për pasurinë 5857 është 198992 Euro.

P.s: Çyftësitëbulgjet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e dorëzuar në BKT, në Rregullatë Samir Hostha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLJALLA).

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës, Tëlf: 052-22-6600  
E-mail: best.2010@permbareme.al, web: www.permbareme.al

## DIASPORA VIZITA

PD publikon videon, ministri me komunitetin në Detroit vihet në siklet nga pyetjet

# Shqiptarët në SHBA "kryqëzojnë" Majkon: Pse nuk arrestohet Tahiri?

"Votuat kundër SHBA, ringjallët simbolet komuniste"

Valentina Madani

Pandeli Majko, ministri shqiptar për Diasporën, po zhvillon në Detroit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës një vizitë zyrtare, duke u njohur përmes takimeve me shqetësimit e komunitetit shqiptar në SHBA. Por gjatë takimeve, ministri është vënë në siklet nga disa prej pyetjeve të tyre për situatën politike në Shqipëri. Ata i kanë kërkuar llogari Majkos për votën kundër SHBA për Jerusalem, për ringjalljen e simboleve të komunizmit dhe përse nuk arrestohet ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri. Shqiptarët i kanë kërkuar 'llogari' ministrit edhe për një sërë çështjesh tjera, ndërsa videoja është publikuar në Facebook nga kreu i Departamentit për Politikën e Jashtme në Partinë Demokratike, Kreshnik Çollaku. Në video vërehet momenti kur Majko thotë se: "Kjo është Amerika dhe Amerika na ka mësuar ne", por videoja ndërpritet në përgjigjet që jep ministri për pyetjet bëra nga shqiptarët. "Diaspora shqiptare në Detroit, SHBA vë me shpatulla pas muri ministrit. Pse votuat kundër SHBA? Pse keni ringjallur simbolet e komunizmit? A do të arrestohet Saimir Tahiri? Ndërkohë videoja është postuar edhe nga ish-kryeministri Sali Berisha në "Facebook". "Në Miçigan diaspora kryqëzon Majkon! Vota juaj kundër Amerikës është votë kundër të gjithë diasporës dhe kombit shqiptar. I kërkojmë dhe pse rikthyet simbolet e komunizmit dhe se a do arrestohet Saimir Tahiri! Shikoni videon e qytetarit dixhital! Sb.", shkruan ish-kryeministri Berisha në "Facebook". Më herët zyra e shtypit e ministrit Majko njoftoi se në takimin e zhvilluar me përfaqësues të komunitetit shqiptar në "Troy Community Center" në Detroit, ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko foli për hapat e ndërmarrja deri më tani dhe gjithashtu për projektet që synojnë mbështetjen dhe krijimin e lehtësirave për shqiptarët e diasporës. Ministri



Pandeli Majko, ministri shqiptar për Diasporën, në Detroit



## Ironia e Harasanit për miqtë e 'Rilindjes': Lum Shqipëria për ju!

Ish-deputeti i Partisë Socialiste, Andis Harasani ironizoi njëdithe edhe si Dita e Miqve. Më këtë rast, Harasani shprehet me ironi, se rilindasit janë shembulli i mirësisë, besës dhe ndershmërisë. "Sot është Friends day. Dua të uroj të gjithë rilindasit! Shembull mirësie, ndershmërie, bese, përkushtimi! Lum Shqipëria për ju!", shkruan në "Facebook", Harasani. Ish-deputeti i PS-së jeton prej vitësh në SHBA, i distancuar nga jeta politike në vend, por që herë pas herë reagon në "Facebook" lidhur me situatën që kalon vendi duke shigjetuar në mënyrë të veçantë Partinë Socialiste, se cilës i përkiste për vite me radhë.



Majko informoi komunitetin shqiptar në Miçigan lidhur me Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin, Komitetin Shtetëror për Diasporën, i cili drejtohet nga kryeministri, Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe qëllimin e saj, e gjithashtu Projektligjin për Diasporën, që siç tha do të rregullojë shlytllat kryesore të organizimit të marrëdhënies së shtetit

shqiptar me diasporën e tij. Ndërsa përmendi përpjekjet për t'u garantuar shqiptarëve jashtë vendit të drejtën e votës, ministri theksoi se diaspora duhet të ketë edhe përfaqësimin e vet politik. Të pranishmit i drejtuan pyetje ministrit lidhur me prioritetet afatshkurtra dhe afatgjata, mbi mënyrat e bashkëpunimit me diasporën, strategjinë dhe mundësinë e

**REAGIMI**  
Gjatë takimeve ministri Majko është vënë në siklet nga disa prej pyetjeve të shqiptarëve në Detroit për situatën politike në Shqipëri. Ata i kanë kërkuar llogari Majkos për votën kundër SHBA për Jerusalem, për ringjalljen e simboleve të komunizmit dhe përse nuk arrestohet ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri.



Protesta e 27 janarit

### DEBATI

"Debati për 29 Nëntorin nuk bëhet nga historianët, por bëhet nga ata njerëz të cilët ishin bashkëpunëtorë me pushtuesin, nuk kishin asnjë lloj kontributi në LANÇ dhe që mundohen që 29 Nëntorin ta fshehin pas 28 Nëntorit, për të fshehur vlerën e vërtetë të LANÇ. Megjithatë, ne besojmë këtë betejë e kemi fituar. LANÇ meriton respektin e të gjithë brezave", tha z.Balla.

## PS përkuqton masakrën e 4 shkurtit

# Debati për 29 Nëntorin, Balla: Për të fshehur vlerat e LANÇ

Në ambientet e gimnazit "Sami Frashëri" u përkuqta dje masakra e 4 shkurtit në nën kujdesin e Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve dhe Heronjve të LANÇ. Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, Balla u shpreh se debati për datat e historisë nuk bëhet nga historianët, por nga ata që nuk kanë asnjë kontribut. Një fakt i rëndësishëm është premtimi që z. Balla u dha familjarëve të dëshmorëve: "Në programin e ardhshëm të këtij sesi, pra në 3 muajt e ardhshëm, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, ne do të kalojmë pikërisht një kuadër të plotë ligjor, i cili



u jep familjeve të heronjve dhe dëshmorëve të atdheut në LANÇ statusin e merituar për kontributin në çlirimin e atdheut. Nuk ka asnjë dyshim që LANÇ është një prej momenteve më të rëndësishme në historinë e atd-

heut tonë, sepse është një prej atyre momenteve ku Shqipëria është radhitur për krahas SHBA, Britanisë së Madhe, Francës, një aliance e cila e çliroi Europën dhe botën nga një e keqe e madhe sikur se ishte nazifashizmi. Në këtë kontekst, masakra e 4 shkurtit është një prej atyre momenteve ku jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë duhet të ndalemi për të kuptuar se si një pjesë e vogël e shqiptarëve u bënë bashkëpunëtorë me pushtuesin dhe duke qenë autorët e urdhëruesit e një prej masakrave më të rëndësishme të ndodhura në rajonin e Tiranës, në 3 duke u gdhirë 4 shkurti".

paraqitur në komisionin e Kuvendit, duke bërë me dije përmbajtjen e tij. Në fund të takimeve, ministri i Shtetit për Diasporën dhe një intervistë për televizionin "Albanian Tv of America", ku foli për çështjet e diskutuara me komunitetin shqiptar atje, për strategjinë për diasporën dhe tema të tjera që prekin shtetasit tanë jashtë vendit.



Prëzimi i qeverisë, opozita e bashkuar diskuton axhendën e protestave të ardhshme

# 20 shkurt dhe 22 mars, nga protestat tek mosbindja civile

Paralajmërimi i PD: Lufta vazhdon për kauzën popullore

Valentina Madani

Opozita e bashkuar ka paralajmëruar se nuk do të ndalë protestat deri në rrëzimin e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie antimagjice. Pas protestës masive në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" më 27 janar, ende nuk ka zyrtarisht një datë se kur do të zhvillohet protesta e radhës. Por burime brenda frontit opozitar bëjnë me dije për 'GSH' se është në diskutim që protesta e radhës të zhvillohet më 20 shkurt, ditën e rrëzimit të bustit të diktatorit Hoxha. Burimet sqarojnë se protesta e fundit që sipas opozitës do të çojë në arritjen e qëllimit, largimin e qeverisë, pritet të jetë data 22 mars, datë e cila përkon me 26-vjetorin e fitores së PD-së në zgjedhjet e 22 marsit 1992. Gjithsesi, krerët e opozitës së bashkuar janë ende në diskutim për vendosjen e datave se kur do të rinisin protestat kundër qeverisë. Liderët e opozitës së bashkuar synojnë të tjera protesta masive me pjesëmarrje edhe më të madhe se ajo e 27 janarit.



Krerët e opozitës së bashkuar

Për afro 4 orë u vunë re debate dhe akuzat të ashpra mes palëve deri dhe përplasja e bidojnë të ujit mbi tavolinë.

"Ai nuk është një parlament, por një dhomë që i mungon legjitimiteti. Ata duan ta përdorin atë dhomë për të ga-

rantuar paprekshmërinë e shokëve të tyre, se me këta kriminelë kanë ardhur në pushtet. Tjetërsuan vullnetin e popullit. Ne do bëjmë atë që bën opozita, do të vazhdojmë të denoncojmë. Bëmë një protestë madhështore dhe të mundësojmë që të mbrohën sa të jetë e mundur liritë e qytetarëve. Duke kritikuar, duke ftuar qytetarët në protestë me qëllim që keqqeverisja të ndikojë sa më pak", u shpreh fill pas seancës kreu i PD-së, Lulzim Basha. Sipas tij, "është një shtet i kapur nga mafia. Do shkojmë të bëjmë teatër në parlament apo do dalim nga aty? Forma më normale për këtë situatë në demokraci është një popull që ngrihet dhe e nxjerr jashtë lojë Ramën nga zyrat e Kryeministrit".

**DISKUTIMI**

Krerët e opozitës së bashkuar janë ende në diskutim për vendosjen e datave se kur do të rinisin protestat kundër qeverisë. Liderët e opozitës së bashkuar synojnë të tjera protesta masive me pjesëmarrje edhe më të madhe se ajo e 27 janarit.



Reagimi i OSHEE: Deputeti ka marrë me qira zyrën

## Berisha: Shalsi s'pagan energjinë, nuk lidh kontratë

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje denoncimin e një qytetari, i cili shprehet se deputeti i PS-së, Eduart Shalsi, ka hapur një zyrë pritjeje në Pogradec, por nuk ka kontratë energjie. Qytetari në fjalë dërgon dhe foto në adresë të Berishës, duke shkruar se ndërta njerëzit burgosen për mospagimin e faturave, deputeti i PS nuk ka vendosur as sahat për matjen e harxhimit. "Për narko-deputetët, energjia elektrike është falas! Lexoni mesazhin dhe shikoni foton e qytetarit dixhital! Sb. Përshëndetje doktor Berisha. Ndërkohë që njerëzit burgosen për mospagimin e faturave të energjisë, deputeti i PS në Pogradec, Eduart Shalsi ka hapur një zyrë pritjeje dhe nga banorët raportohet se lidhjen e energjisë e ka bërë pa kontratë dhe pa sahat matjeje të harxhimit", thuhet në denoncimin drejtuar z.Berisha. Pas denoncimit të bërë nga ish-kryeministri Berisha se deputeti i PS-së, Eduart Shalsi, nuk paguan energjinë në një zyrë të hapur për diskutim me qytetarët në qytetin e Pogradecit reagoi OSHEE. Në lidhje me akuzën e deputetit Berisha, sipas të cilit deputeti Eduard Shalsi konsumon energji elektrike duke shmangur pagesat në zyrën e tij të pritjes për banorët në Pogradec, sqarojmë se: "Nga verifikimi në terren rezultoi se ambienti është brenda një kompleksi hoteli, ku z.Shalsi ka marrë me qira zyrën, sipas marrëveshjes kontraktuale me subjektin privat që disponon kontratën e furnizimit me energji elektrike me OSHEE, konform procedurës".



**NJOFTIM**

Në kuadër të zgjerimit të rrjetit dhe aktivitetit të saj FIRST INVESTMENT BANK – ALBANIA SHA njofton për vendet vakante, si më poshtë vijon:

- 1. **SME Relationship Manager** – 2 pozicione vakante (Tiranë);
- 2. **Administrator i bazës së të dhënave** – 1 pozicion vakant (Tiranë);
- 3. **Help Desk** – 1 pozicion vakant (Tiranë);
- 4. **Specialist junior në Departamentin e Administrimit të Kredive dhe operacioneve** – 1 pozicion vakant (Tiranë);
- 5. **Specialist i mbledhjes së kredive në vonesë** – 1 pozicion vakante (Tiranë);
- 6. **Oficer i sigurisë fizike** – 1 pozicion vakant (Tiranë);
- 7. **Specialist ligjor (Jurist) pranë Departamentit Juridik** – 1 pozicion vakant (Tiranë);
- 8. **Vlerësues i pasurive të paluajtshme** – 1 pozicion vakant (Tiranë);
- 9. **Hapje të 2 Degëve të reja në qytetin e Tiranës dhe 1 Degë në qytetin e Lezhës;**
- 10. **Drejtor Dege** – 2 pozicione vakante (Deget Tiranë);
- 11. **Drejtor Dege** - 1 pozicion vakant (Dega Lezhë);
- 12. **Bankier personal** – 4 pozicione vakante (Deget Tiranë);
- 13. **Senior Retail Relationship Manager** – 1 pozicion vakant (Dega Tiranë);
- 14. **Retail Relationship Manager** – 4 pozicione vakante (Deget Tiranë);
- 15. **Retail Relationship Manager** – 1 pozicion vakant (Dega Elbasan);
- 16. **Retail Relationship Manager** – 1 pozicion vakant (Dega Fier);
- 17. **Retail Relationship Manager** – 1 pozicion vakant (Dega Vlore);
- 18. **Retail Relationship Manager** – 1 pozicion vakant (në Degën Lezhë);
- 19. **Retail Relationship Manager** – 1 pozicion vakant (Dega Durrës);
- 20. **Arkëtare** – 2 pozicione vakante (Deget Tiranë);
- 21. **Arkëtar** - 1 pozicion vakant (Dega Lezhë);

Të gjitha pozicionet vakante të punës janë të publikuara në [www.fibank.al](http://www.fibank.al)

Për aplikim, personat e interesuar duhet të dërgojnë në adresën e mailit të Burimeve Njerëzore [hr@fibank.al](mailto:hr@fibank.al), brenda datës **17.02.2017**.

- CV-në e përditësuar;
- Letrën e interesit

## INVESTIMET PUNESIMI

Përurohet info-Kulla në Rubik, qendër e re e informacionit për turistët

# Investimi në Spaç, Rama: Nuk duhet të mungojnë kapacitetet

"Jo vetëm vende, edhe aftësi për punë"

Kryeministri Edi Rama ishte në Mirditë, ku u njoh me investimin e kryer në fabrikën e përpunimit të bakrit. Sipas shefit të qeverisë, ky sektor po njeh një zhvillim që ka munguar prej 20 vitesh. Në zonën ku më parë ngrihej burgu famëkeq i Spaçit, një kompani private ka investuar 25 milionë dollarë dhe ka punësuar 200 punonjës. "Në fund të projektit investimi total do të jetë 25 milionë dollarë. Së bashku me nënkontraktorët janë afro 200 persona që po punojnë, por numri mund të shkojë në 300", tha përfaqësuesi i kompanisë. Sipas tij: "Kemi vështirësi për të gjetur sidomos persona teknikë". Por, problemi më i madh duket se është mungesa e profesionistëve, një shtetësim që kryeministri e përmend sa herë flitet për punësimin. "Nuk është thjesht çështja të krijojmë vende pune, por edhe të krijojmë aftësi për punë, sepse na ndodh vazhdimisht që punë ka, por mungojnë kapacitetet teknike për të bërë ato lloj punësh. Ne kemi hapur një shkollë profesionale për minierat këtu në Bulqizë, me sistemin që një pjesë të javës e kalojnë në shkollë, një pjesë në punë, e cila ju ndihmon edhe ju, ndihmojmë edhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit. Ky është një sektor që ka pasur shumë problematika nga të gjitha pikëpamjet, të sigurisë, të zhvillimit dhe punësimit".



Kryeministri Edi Rama dhe një grup të tjerë në Mirditë

### PUNËSIMI

"Nuk është thjesht çështja të krijojmë vende pune, por edhe të krijojmë aftësi për punë, sepse na ndodh vazhdimisht që punë ka, por mungojnë kapacitetet teknike për të bërë ato lloj punësh", tha z.Rama.

### LSI



Vasili: Një psikiatër për kryeministrin Edi Rama

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, "kërkuar" një psikiatër për kryeministrin Rama. Ai shkruan në 'FB' se duhet 't'ua lënë në dorë punën psikiatërve'. Vasili ironizon edhe postimin e Edi Ramës, të bërë në mes të natës e duke thënë 'mirëmëngjesi'. "Kryeministri përshëndet në mesnatë me det kur Shqipërinë e mori lumi. Bëjini një derman këtyrë kryeministrin tonë. Shqipëria është në hall nga përmbytjet dhe mijëra familjeve u kërcënohet prona dhe jeta dhe ky i përshëndet në 'FB' në mes të natës me foto nga deti në behar. Ky kryeministri e thotë shqeto 'bëjini dermanin vetë vetes, se unë kam qejfin tim'. Në këtë situatë që ndodhet ky kryeministër që s'di ç'flet dhe që na thotë në mes të natës mirëmëngjesi me det kur shqiptarët i mori lumi, politika të bëjë pak mënjane dhe t'ua lërë në dorë punën psikiatërve", shprehet z.Vasili.

### Denoncimi, urgjenca pa energji elektrike

## Rama në Domgjon: E pabesueshme, degradim nga politika e tepsisë



### Akuza

"Ne kemi Drejtori Rajonale të Shërbimit Parësor, por kur vjen një informacion i tillë, na ka munguar me vite. Ky është realiteti, s'kemi çfarë të fshehim. Shprehje flagrante e degradimit të shtetit nga politika e tepsisë", tha z.Rama.

dhe në vetëm 10 ditë vjen përgjigja zyrtare", shkruan Rama në "Facebook". Ndërsa më tej, ai deklaroi se megjithëse u duk si absurditet ky informacion, doli të ishte një situatë e pabesueshme por realiteti. "Në fakt, ne erdhëm këtu sot jo sepse është bërë ndonjë çudi apo sepse u zgjidh një rast pasi në platformën e bashkëqeverisjes që ka vetëm 3 muaj që është ndezur si ekran për të gjithë qytetarët janë zgjidhur mijëra raste, por erdhëm këtu sepse u desh një qytetar që mori vesh se nuk është lidhur akoma energjia elektrike. Në fillim u duk si absurditet pastaj kur u futëm më thellë, ministria u angazhua vetë, zbuluan një situatë të pabe-

sueshme që nuk ishte vetëm kjo qendër, por ishin 30 qendra shëndetësore në Mirditë, që nuk ishin bërë lidhje me energjinë elektrike dhe disa qindra mijëra qendra shëndetësore nëpër Shqipëri që nuk kishin bërë lidhje. Një gjë e qartë që tregon se sa shumë punë kemi për të bërë shtetin. Ne kemi Drejtori Rajonale të shërbimit Parësor, por kur vjen një informacion i tillë na ka munguar me vite. Ky është realiteti, s'kemi çfarë të fshehim. Shprehje flagrante e degradimit të shtetit nga politika e tepsisë. Shko drejtori ti aty, ti këtu dhe drejtori e ka pas mendjen për punët e veta. Ne po bëjmë dicka që erdhi si rezultat i ankesës së një njeriu. Platforma e bashkëqeverisjes funksionin. Koha kur qytetarit trajtohej keq dhe nuk kish xhami e kishë ku të falej ka mbaruar", deklaroi kryeministri.

Kryeministri Edi Rama kishte në Mirditë, ku vizitoi qendrën shëndetësore të Domgjonit, pas një ankese në platformën e bashkëqeverisjes. Një qytetar denoncoi se në këtë qendër shëndetësore nuk ishte lidhur energjia elektrike, por pas këtij denoncimi u zbulua se vetëm në Mirditë ishin pa energji elektrike 30 qendra shëndetësore e akoma më keq sipas kryeministrin qindra mijëra në të gjithë Shqipërinë. Ai tha se u desh informacioni nga një qytetar, pasi nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit parësor nuk ka ardhur ky informacion me vite. Rama e quajti shprehje flagrante të degradimit të shtetit nga politika e tepsisë. "Mjaftoi ankesa e një qytetari në Platformën e Bashkëqeverisjes 'shqiperiaqedua.al', që jo vetëm të bëhej lidhja me energjinë në ambulancë e largët të fshatit Domgjon, po që edhe të zbulohej një fenomen shumëvjeçar i qendrave shëndetësore të palidhura kurrë me energjinë në zona të ndryshme rurale. Duhet vetëm 3 minuta për të angazhuar direkt qeverinë për një ankesë personale apo lidhur me komunitetin

timet në agroturizim do t'i jepet shumë impakt ekonomik dhe social Shqipërisë që jeton në fshat", theksoi kryeministri Rama. Kryeministri u shoqërua nga ministri

ton ndërtimit e një rrjeti qendrash të ngjashme që lidhen mes tyre përmes internetit. "Çdo bashki mund të gjejë karakteristikën e vet për të ndërtuar një qendër të tillë

dhe pastaj të gjithë ato qendra t'i lidhim në rrjet përmes teknologjisë dixhitale, në mënyrë që të kemi një bum informacioni dixhital për turistët", deklaroi z.Rama.

Kryebashkiaku socialist të Mirditës, z.Rama i kërkoi që vëmendje t'i kushtohet dhe projektit të qeverisë për zhvillimin e agroturizimit në këtë zonë.

# ABUZIMI ME TENDERAT ARRESTIMET

Lihet në qeli Dashamir Xhika dhe Andi Toma. Prokuroria: I shkaktuan dëm prej 5 miliardë lekësh shtetit

## Rruga Tiranë-Elbasan, pranga edhe dy drejtorëve të tjerë

Aksel Qurduku dhe Alben Alite, ish-drejtuës në Njësinë e Menaxhimit

Ina Allkanjari

### ELBASAN

**P**riten dy flet-arreste të tjera pas prangosjes së dy ish-drejtorëve të rrugëve Dashamir Xhika dhe Andi Toma. Aksel Qurduku dhe Alben Alite, ish-drejtuës në Njësinë e Menaxhimit të projektit Tiranë-Elbasan do të gjykojnë për shpërdorim detyre e korrupsion. Ndërkaq në Gjykatën e Elbasanit është zhvilluar ditën e djeshme seanca gjyqësore ndaj ish-kreut të ARRSH, Dashamir Xhika dhe 9 personave të tjerë, të cilët sipas prokurorisë, i shkaktuan një dëm shtetit prej 5 miliardë lekësh, pasi abuzuan me tendera. Pavarësisht tensionit dhe debateve mes palëve, gjykata vendosi të lërë në burg ish-drejtorin e Rrugëve, Dashamir Xhikën, Andi Tomën (ish-drejtor i Përgjithshëm i Rrugëve nga viti 2008-2013), Rexhep Tarba (mbikëqyrësi i punimeve në rrugën e Gjinarit), Agron Hysën, Kujtim Hysën. Ndërsa është lënë në arrest shtetpije Rezarta Bokciu, administratore e firmës "Arifaj", si dhe pesë zyrtarët Lek Tusha, Astrit Qafa, Malvina Kallabaku, Afërdita Basha dhe Kastriot Braha, të cilët dyshohen për kolaudimin fiktiv të rrugës. Sakaq, i pranishëm në sallën e gjyqit në mbështetje të Dashamir Xhikës mësohet të ketë qenë edhe ish-ministri i LSI, Edmond Haxhinasto.

### SEANCA GJYQËSORE

Në seancën e djeshme parashikohej verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së sigurisë, si dhe fakti nëse të ndaluarit ishin njohur me masën e sigurimit e të drejtën e ankimit. Seanca u shoqërua me debate të forta mes palëve, ku avokatët mbrojtës kërkuan që gjykatësja Idushe Maliqi të tërhiqej nga procesi kundër dy ish-drejtorëve të përgjithshëm të Rrugëve, Andi Toma dhe



Ish-kreu i ARRSH, Dashamir Xhika

Dashamir Xhika. Kërkesa për përjashtimin e gjykatësës u bë nga avokati Neshat Fana, që mbrojnë Andi Tomën dhe Artan Hajdari që mbrojnë interesat e Dashamir Xhikës, të cilët pretenduan me forcë se Maliqi ka shkelur ligjin duke urdhëruar kontrollin e banesave të klientëve të tyre në orët e vona të mbrëmjes. Gjatë seancës, avokatët mbrojtës ngritën pretendimet e tyre për

akuzat, duke u shprehur: "Prokuroria pretendon se është shkaktuar dëm ekonomik, ndërkohë që kontrata nuk ka përfunduar". Ndërkohë, prokurorja Armanda Xhaferri i akuzoi mbrojtësit se po bëjnë çmos për bllokimin e procesit. Pas debateve të ashpra, gjykatësja u tërhoq në dhomën e këshillimit, duke informuar pak minuta më vonë se seanca për komunikimin e masës

për të dyshuarit do të shtyhet për një orë të mëvonshme. Me rinisjen e seancës gjyqësore u bë i ditur rrëzimi i kërkesës së avokatëve për dorëheqjen e gjyqtarës Idushe Maliqi, nga shqyrtimi i kësaj çështjeje. Ndërkohë, prokurorja Armanda Xhaferri kërkoi largimin e medias nga salla e gjyqit duke theksuar se në vijim do të paraqiteshin dokumente që janë sekret hetimor.

### ARGUMENTET E AVOKATËVE

"Prokuroria pretendon se është shkaktuar dëm ekonomik, ndërkohë që kontrata nuk ka përfunduar dhe garancia e punimeve në zotërim nga ARRSH është më e madhe se dëmi i pretenduar nga prokuroria. Gjyqtarja u tërhoq sepse 4 avokatë u shprehën se ajo kishte shkelur procedurat ligjore. Kishte pranuar kërkesat absurde të prokurorisë, nuk kishte vlerësuar provat (nuk kishte asnjë provë në vendimin e gjykatës për pranimin e masës së sigurimit të kërkuar nga prokuroria) dhe ishte e paragjykuar për çështjen. U kontestua fakti që ka qat vite (mbi dy vite) që hetohet çështja dhe të akuzuarit janë paraqitur rregullisht. Pse tani futen në burg (masë e sigurisë me burg)? U kontestua gjithashtu edhe masa e sigurisë me burg, sepse ata nuk paraqesin rreziqshmëri shoqërore", deklaruan avokatët mbrojtës.

### KRIMET E RËNDA

Në një çështje të ndarë nga ajo që po shqyrtohet në Gjykatën e Elbasanit,

Gjykata për Krimet e Rënda vendosi masën e sigurisë arrest me burg për ish-kreun e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Dashamir Xhika.

Ky vendim erdhi në kohën që në gjykatën e Shkallës së Parë në Elbasan zhvillohej seanca për caktimin e masës së sigurisë ndaj të arrestuarve për abuzime në rrugën Elbasan-Gjinan, mes të cilëve edhe ish-kreut të ARRSH Dashamir Xhika. Ndaj këtij të fundit një tjetër prokurori ditën e djeshme ka lëshuar urdhër arresti për akuzën me korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Komunikimi i urdhrit të lëshuar nga prokurorja e Krimeve të Rënda, Elisabeta Imeraj është bërë në ambientet e policisë së Elbasanit, ku Xhika qëndron i arrestuar për një çështje tjetër. Së bashku me Xhikën është urdhëruar të arrestohen edhe dy persona të tjerë, njëri prej tyre është Altin Cueduku. Masa e arrestit nga Krimet e Rënda kërkohet për kallëzimin e ministrit Gjoknuri për rrugën Tiranë-Elbasan. Tashmë pritet që dosja ndaj Dashamir Xhikës të kalojë te Krimet e Rënda.

## LSI merr në mbrojtje ish-kreun e ARRSH

### Petrit Vasili: Prokuroria është vegël e krimit, e vënë përfund nga Rama



Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili

dështoi me akuzat në gjyqin ndaj z.Xhika, një ish-nëpunës i shtetit dhe sot që pa gdhirë me urdhër politik shpiku një tjetër akuzë ndaj tij. Kjo prokurori që nuk arreston Saimir Tahirin, akuzat ndaj të cilit i di gjithë e Shqipëria dhe përgjimet e të cilit i ka dëgjuar çdo shqiptar. Kjo prokurori që ka prej vitesh denoncimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për Gjoknurin për grabitjen e 650 milionë euro për CEZ. Kjo prokurori që nuk arres-

ton ministren e Drejtësisë që ekstradoi duke dhunuar ligjin Nazer Seitaj, që po vetë kjo prokurori e kish arrestuar. Kjo prokurori që mbyll dosjen e Ramës, sepse ky kërkoi falje në "Facebook", pasi ai shkattëroi zgjedhjet duke i bërë thirrje policisë të lërë uniformat dhe të bëjë vota për Partinë Socialiste. Kjo prokurori e vënë përfund nga kryeministri me kërcënimin e vetingut i dha fund besimit të shqiptarëve te drejtësia. Prokurorinë e Ramës, Markut e Xhafaqit nuk e beson më askush.

### PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

"Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e treta për shitjen e pasurisë së paluajtshme "1/4 pjesë ideale takuese e debitorit Hysën Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajtshme e llogji apartamenti, me numer pasurie 4/894-1-3, Vllami 11, Faxe 23 ne Zonen Kadastrale Nr.8150, me sipërfaqe prej 78.94 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne Tirane, Adresa: Rr.Cemal Stafa, Shkalla 1, Kati 2, Ap.3", per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Relif Çopeli, per shumen 10.400 Usd dhe 165.932 lekë. Çmimi me të cilin fillon ankandi i treta është ne vleren 932.478.78 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tete pike shtatëdhjetë e tete) lekë. Ankandi i treta zhvillohet ne date 14.02.2018, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email : ermirgodaj@zyraperbarimit.com."

### PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e dyte per shitjen e pasurisë se paluajtshme "Trulli", me Nr.Pasurie 7/91, Vllumi 14, faxe 97, Zona Kadastrale 8370, me sipërfaqe totale 186.70 m<sup>2</sup>, nga e cila ndertese me sip. 62.70 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne Rr. "Haxhi Sina", Tirane, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorëve Shasime Mera, Ajet Dema, Lirim Kastrati, per shumat 90'144(nëntëdhjetë mijë e njëqind e dyzete e kater)Euro dhe 880'015(steqind e tetëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë)Leke. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 67'200(gjashtëdhjetë e shtate mijë e dyqind)Euro. Ankandë zhvillohet ne date 12.02.2018, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyraperbarimit.com.



### SHPLLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Palli 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 26.02.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shitjen e pasurisë te paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m<sup>2</sup>, me Nr pasurie 1/1544-1-4, Vll.7, Fq.247 me vliere fillestare ne ankand 24.570 EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Uniformat blu, pritë 4 personave në Lezhë, sekuestrohen 131 kg kanabis e arsenal municionesh

# Kurbin, qëlloi me armë në ajër dhe kërcënoi shokët e punës, arrestohet 21-vjeçari

## Policia: Në vendin e ngjarjes u sekuestruan 3 gëzhoja

LEZHË

Policia e Lezhës ka parandaluar ditën e djeshme një krim të rëndë, duke vënë në pranga 21-vjeçarin Mikel Gjonaj, i cili ka kërcënuar shokët e tij të punës duke qëlluar me pushkë në ajër. 21-vjeçari nga fshati Drojë i Kurbinit ka kanosur me armë punonjësit e një gurorjeje, por policia ka ndërhyrë në kohë dhe ka arrestuar Gjonajn e ka sekuestruar armën dhe 10 gramë kanabis. Bëhet me dije se specialistët për Hetimin e Krimin në Komisarriatin e Policisë Kurbin arrestuan në flagrancë shtetasin Mikel Gjonaj, 21 vjeç, banues në Fashti Drojë, Kurbin. Sipas të dhënave nga uniformat blu, arrestimi në flagrancë i tij u krye pasi ka qëlluar me armë në ajër dhe



ka kanosur për motive të dobëta disa punonjës të një firme gurorjeje, ku ishte i punësuar. Ndërhyrja në kohë e shërbimeve të policisë së Kurbinit parandaluan konfliktin, si dhe kapën shtetasin së bashku me armën e zjarrit tip pushkë. Gjatë kontrollit fizik, policia i gjeti në trup edhe 10 gr kanabis. Në ven-

din e ngjarjes grupi hetimor gjeti dhe sekuestroi 3 gëzhoja. Materialet në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për veprat penale "Kanosja", "Mbahjtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe municionit" dhe

**ARRESTIMI**

Specialistët për Hetimin e Krimin në Komisarriatin e Policisë Kurbin arrestuan në flagrancë shtetasin Mikel Gjonaj, 21 vjeç, banues në Fashti Drojë, Kurbin. Arrestimi u krye pasi ka qëlluar me armë në ajër dhe ka kanosur disa punonjës të një firme gurorjeje, ku ishte i punësuar.

**U akuzua për tritolin te farmacia e Bashkim Tahirit, i riu kërkon dëmshpërblim**

Dy vite më parë, Baftjar Bruka u soll në Shqipëri nga Suedia, si i dyshuari kryesor i vendosjes së një sasie lënde shpërthyeshe në farmacinë e Bashkim Tahirit, babait të Saimir Tahirit, asokohe ministër i Brendshëm. Shpërthimi në farmacinë e zotit Tahiri në shkurt të vitit 2015 dhe vendosja e një tjetër sasie tritolit po atë natë pranë një stacioni autobusi, që në fakt nuk shpërtheu, u cilësuan akte terroriste. Por 10 muaj pasi e mbajti nën arrest, Prokuroria e Krimin në Rënda u tërhoq nga dyshimet e saj, duke pushuar hetimet për të dyja rastet. Organi i Akuzës deklaroi se nuk kishte mundur të gjente prova dhe motive për këto dy ngjarje. Tani, Baftjar Bruka kërkoi rreth 870 mijë lekë dëmshpërblim për 290 ditë që qëndroi në paraburgim. Çdo ditë paraburgim i padrejtë paguhet 3.000 lekë. Çështja e dëmshpërblimit do të gjykohe në Gjykatën Administrative të Tiranës.

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Sakaq, ditën e djeshme policia e Lezhës ka zhvilluar një operacion në rrugën Bukmir-Kallmet, ku kanë rënë në pranga katër persona. Bëhet me dije se shtetasit e arrestuar janë të moshave nga 26 deri në 55 vjeç. Gjatë kontrollit të tyre uniformat blu kanë gjetur dhe sekuestruar një sasi të madhe droge dhe municionesh. Sipas të dhënave zyrtare, policia e Lezhës arrestoi në flagrancë shtetasit Xh.G., A. G., N.G. dhe P.G., përkatësisht 30 vjeç, 35 vjeç, 55 vjeç e 26 vjeç, banues në Lalm i Ri dhe Ishull Lezhë. Bëhet me dije se gjatë operacionit policor janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 131 kg kanabis sativa, 30 fisekë model 56, 53 copë kapsolla detonatorë, 10 copë fitila zjarr përcjellës me gjatësi 80 cm si dhe një kallëp tritol. Materialet për këtë çështje i kanë kaluar për procedime të mëtejshme prokurorisë.

**SHKURT**

**Tentoi të trafikonte 54 kg marijuanë, policia greke arreston shqiptarin**

Gjatë një operacioni antidrogë në aksin Kapshticë-Kostur, policia greke ka arrestuar ditën e djeshme një shqiptar dhe është shpallur në kërkim një tjetër. Mësohet se policia greke ka tentuar të ndalojë një automjet, por drejtuesi nuk i është bindur urdhrin, duke shtuar shpejtësinë dhe është larguar në drejtim të kufirit të gjelbër. Policia greke ka vazhduar ndjekjen dhe ka arritur të pika së Botaniko, Kostur mjetin me dy të dyshuar shoferin dhe pasagjerin. Sapo kanë parë policinë, ata janë futur me këmbë në pyll. Nga ndjekja është arritur të kapet dhe prangoset njëri prej të dyshuarve. Bëhet fjalë për një shqiptar 1 moshe 47 vjeç, ndërsa pranë mjetit janë gjetur dhe sekuestruar 3 çanta me 8 pako që përmbanin 54 kg 463 gramë marijuanë. Viojnë kërkimet për kapjen e të dyshuarit tjetër, i cili rezultoi të jetë drejtuesi i mjetit.

**Kërkohe për disa vepra penale, kapet në Kapshticë 44-vjeçari nga Mati**

MAT - Policia e Matit në bashkëpunim me policinë Kufitare të Kapshticës kanë vënë në pranga një 44-vjeçar të shpallur në kërkim e të dënur për disa vepra penale. Sipas të dhënave zyrtare, në vijim të punës për kapjen e personave të shpallur në kërkim, është arrestuar shtetasi Hazbi Kurtaja, 44 vjeç, banues në Klos. Ky shtetas është shpallur në kërkim nga Komisarriati i Policisë Mat për veprat penale "Dhunë në familje", "Vjedhje e energjisë elektrike" dhe "Mbahjtja pa leje të armëve luftarakë", si dhe për këtë shtetas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat më datë 02.11.2015 ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me Burg". Materialet i kaluan Prokurorisë së Matit për veprime të mëtejshme.

**QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZVILLIMIN**  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Vendi i punës: Menaxher Programi  
Vendodhja: Tiranë  
Afati i fundit i aplikimit: 15 shkurt , 2018

**Organizata:** Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zvillimin (OSHPZH) është një organizatë jo-fitimprurëse e angazhuar në çështjet e popullsisë dhe zhvillimit, përmes advokacisë për përmirësimin e legjislativës dhe politikave të fushës, ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat e tyre si dhe nxitjes dhe sigurimit të aksesit të barabartë për shërbime sociale dhe shëndetësore dhe arritshme të përballueshme pavarësisht nga distanca apo statusi shoqëror.

**Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Ndihmon në formulimin e politikave dhe programeve të organizatës, përcaktimin e objektivave dhe procedurave përkatëse për zbatim.
- Ndihmon në përdorimin eficient të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave të organizatës.
- Ndihmon në drejtimin e veprimtarisë së përditshme administrative të organizatës.
- Mbikqyr zbatimin e projekteve mbi bazën e planifikimit, buxhetimit, dhe proceset e monitorimit të projekteve.
- Së bashku me Drejtorin Ekzekutiv harton Planin e Punës Vjetor sikurse dhe bashkëpunon me Financierin për të planifikuar dhe buxhetuar, bazuar në objektivat dhe rezultatet që duhen arritur.
- Koordinon punën e koordinatoreve të projekteve, për të realizuar indikatorët e planifikuar.
- Siguron që aktivitetet e projektit të jenë në përputhje me politikën dhe rregulloret e OSHPZH-së.
- Harton projekte dhe dokumenta të shoqatës.
- Pergatit raporte progresive dhe finale sic kërkohe nga programi dhe raportin rregullisht tek Drejtori Ekzekutiv.
- Siguron shpërndarjen e gjere dhe vizibilitetin e arritjeve të programit.
- Perfaqëson kur është e nevojshme organizatën në takime dhe forume brenda e jashtë vendit.

**KUALIFIKIMET DHE AFTESITË E KERKUARA**

- Edukimi:**
  - Diplomë Universitare Master, preferohe nivel shkencor dhe në fusha të lidhura me çështjet sociale, dhe/ose në fushën e menaxhimit.
- Eksperiencë:**
  - Te pakten 5 vjet eksperiencë në Menaxhim Programi dhe/ose Projektesh në organizatat jo-fitimprurëse, institucionet e administratës publike ose sektorin privat.
- Aftësi:**
  - Njohuri shumë të mira të kompjuterit.
  - Njohuri shumë të mira të Paketës Office (MS Word, Excel, etj.)
  - Preferohen njohuri në administrim database.
  - I/E afte të beje kerkime në internet.
  - Aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, e për të dhënë mendime alternative.
  - Aftësi për të punuar në ekip, transparencë në punë.
  - Aftësi për të punuar nën presion, me orar të zgjatur dhe jashtë vendbanimit.
  - Aftësi të shkëlqyera në shkrim dhe komunikim verbal në gjuhën angleze. Çdo gjuhë tjetër është një plus për kandidatin.

Mirëpresim të gjithë kandidatët e interesuar, të dergojnë elektronikisht në [info@acpd.org.al](mailto:info@acpd.org.al) dokumentat e mëposhtme:

- leter motivimi,
- nje kopje te jeteshkrimit (C.V),
- fotokopje e leternjofimit (kartes së identitetit),
- fotokopje e diplomes/diplomave shoqëruar me listë notash,
- dokumenta të tjera që vërtetojnë eksperiencën e kualifikime.

Afati i dorëzimit të dokumenteve është data 15 shkurt 2018  
Kandidatët që do të kualifikohen nga piclesimi i kriterëve nëpërmjet shqyrtimit të dokumentave do të njoftohen për kohën e testimit pranë organizatës.

Republika e Shqipërisë  
Instituti i Statistikave

### INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA TENDER NOTIFICATION

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for "Equipment for data center and network, and installation", in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training center, with Sida contribution nr: 55020289.

The tender dossier is available at [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al): from **January 22, 2018**.

The deadline for submission of tenders is **February 22, 2018**, time 11.00 AM, at Institute of Statistics of Albania, Blv. Zhan D'Ark, No. 3, Tirana, Albania.

Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al), <https://www.kommersannons.se/sida/>.

Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to the date of submission of offers.



# VRASJA NE TIRANE DESHMITE

Prokuroria rindërton skemën e krimit, zbulohen lëvizjet e vrasësit

## Ekzekutimi i Kasmit, zbardhen dëshmitë e Dinellarit dhe Halipajit

Pas grekut, edhe 3 të pandehurit e tjerë mohojnë akuzat

Pas mohimit të akuzave të grekut Eftymiuos, i dyshuar si ekzekutori i Devi Kasmit, edhe 3 të arrestuarit e tjerë Elton Hoxhallari, Elton Halipaj dhe Malvin Dinellari janë shprehur para hetuesve se nuk kanë lidhje me atentatin e 29 janarit. Mësohet se Malvin Dinellari ka thënë përpara hetuesve se me vëllezërit Hoxhallari është njohur nga një mik. Dinellari jeton në Korçë, por vinte shpesh në Tiranë pasi ka të fejuarën në shkollë. "Tako-hesha shpesh në Yzberisht me Aurel Hoxhallarin, por nuk kisha dijeni për aktivitetin e tij kriminal. Edhe me grekun jemi ulur në kafe, por e njihja si mik të Aurelit. Punoja me shitje makinash. Aureli më kërkoi t'i gjeja një furgon mallrash. Kërkova në internet dhe e gjeta. E çova në servis për ta kontrolluar dhe Aureli ra dakord për ta blerë. Më dha 4200 euro dhe furgonin e regjistron në emrin e Elton Halipajit", - është shprehur Malvin Dinellari. Ndërkohë, Elton Halipaj ka thënë se ka njohje me Aurel Hoxhallarin dhe i kishte kërkuar atij t'i gjente punë, pasi kishte nenën të diagnostikuar me tumor dhe kishte nevojë për të ardhura. Aureli i punësoi si kopshtar tek vila në Mëzës dhe i kërkoi në emrin e tij të regjistrojë një furgon mallrash, pasi do i nevojitej për punë. Për këtë arsye e regjistroi dhe në një kurs patente. Halipaj pranonte që shkonte te vila në Mëzës, por mohon të ketë lidhje me grupin kriminal, armët, drogën apo vrasjen e Devi Kasmit.

### SKENA E KRIMIT

Organi i akuzës ka rindërtonur të plotë skenën e vrasjes së Devi Kasmit. Në dosjen e prokurorisë thuhet se ish-speciali grek, Eftymiuos, rreth orës 18:30 të mëbrëmjes së 29 janarit shfaqte duke hyrë në rrugicën "Petro Cani" pranë Peditarisë. Pak minuta përpara tij, në këtë rrugicë kishte hyrë me motor Mario Meshini, mik me viktimit. Eftymiuos dyshohet të ketë qëlluar për vdekje 41-vjeçar-in Kasmi poshtë shtëpisë së viktimës përdorte si bazën për aktivitetin e paligjshëm, për të cilën nuk kishin dijeni familjarët, por vetëm një rreth i ngushtë personash të



I arrestuari, Elton Halipaj



Greku, Eftymiuos Eftymiuos

### Autorët ndoqën viktimën përpara se të kryenin ekzekutimin

## Atentati i 29 janarit, momenti i vrasjes

Rreth orës 18:44 të 29 janarit, uniformat e blu janë njoftuar nëpërmjet një telefonate se në rrugën "Kongresi i Manastirit" ka të shtëna me armë. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar forca të shumta të policisë, ku ka rezultuar se në një rrugicë që lidhet me rrugën "Kongresi i Manastirit", në afërsi të Morgut është vrarë me armë zjarri shtetasi Devi Kasmi, 41 vjeç. Nisur nga dinamika e ngjarjes, autorët e kanë gjurmuar viktimën deri në momentin kur është futur në rrugicën e ngushtë dhe të errët. Ngjarja e rëndë ka ndodhur 50 metra larg spitalit të Peditarisë në një rrugicë të ngushtë dhe të errët, ndërsa 100 metra më larg ndodhet godina e Shërbimit Informativ Shtetëror. Po ashtu, thuhet se njëri nga



Devi Kasmi

besuar. Në dosje thuhet se ish-speciali grek ka zgjedhur të largohet nga një rrugicë tjetër, duke dalë sërish në rrugën "Kongresi i Manastirit", ku e priste një furgon i bardhë me targa AA 231 JH. Në momentin kur ai ngjitet në furgon, një kamera siku-

atentatorët priste në motor dhe tjetri në këmbë, duke i zënë prite viktimës. Zona ku ndodhi ngjarja nuk kishte kamera sigurie, pasi ishte një rrugicë pa ndriçim dhe pa biznese. Pista kryesore që po hetohet është ajo e konflikteve që ka pasur Devi Kasmi në të kaluarën. Viktima ka ndryshuar emrin pasi më parë quhej Dëfrim. Dyshohet se viktima merrej me veprimtari kriminale dhe rezultoni një person i njohur me policinë e Tiranës, pasi është dënuar në 2010-ën për falsifikim dokumentesh. Fakti që ai mbante dy armë zjarri pistoletë me vete tregon se Kasmi i druhej një atentati ndaj tij. Ndërkohë, e gjithë ngjarja është parë nga dy infermiere, të cilat kanë qenë duke kaluar në rrugën ku ndodhi atentati.

ria ka fiksuar fytyrën e të dyshuarit, pasi ishte i pamaskuar. Nga hetimet rezultoi se furgonin e drejtonte i dyshuari tjetër, Elton Halipaj. Para hetuesve, Halipaj ka pranuar që ka marrë me furgon shtetasin grek, afër spitalit Peditrik, por nuk

kishte dijeni për përfshirjen e tij në vrasje. Sa i përket furgonit të përdorur në ngjarje, prokuroria ka mundur të zbulojë se është blerë nga grup kriminal që drejtohej nga Aurel Hoxhallari, tashmë në kërkim, më datë 17 janar, 12 ditë përpara krimit. Sipas

**GREKU EFTYMIUOS EFTYMIUOS**  
Shtetasi grek, i cili u arrestua nga uniformat blu pasi dyshohet të jetë ekzekutori i Kasmit, e ndoqi për një kohë të gjatë viktimën për të mësuar rutinën e tij të përditshme. Mendohet se Eftymiuos ishte kontraktuar nga grupi kriminal për të vrarë 41-vjeçar-in. Për këtë, ai erdhi në dhjetor në Shqipëri, ku ka studiuar zonën dhe pikat më të frekuentuara të Devi Kasmit. 3 ditë para ekzekutimit, ish-ushtaraku grek Eftymiuos është parë të bënte lëvizje të shpeshta pranë palestrës së Kasmit.



### ARRESTIMET

Pesë ditë pas atentatit mafioz në kryeqytet, policia e Tiranës ka vënë në pranga ekzekutorin e Devi Kasmit si edhe bashkëpunëtorët e dyshuar tij. Konkretisht janë arrestuar Elton Halipaj, i cili siguroi mjetet për kryerjen e krimit, Malvin Dinellari i cili përgatiti infrastrukturën dhe Elton Hoxhallari, bashkëpunëtor në sigurimin e mjeteve. Ndërkohë, uniformat blu shpallën në kërkim edhe (Altin) ose Aurel Hoxhallarin, që dyshohet si organizatori i një grupi të strukturuar kriminal.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Permbirimore "E.G Bailiff Service" me përmbareues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 16.02.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shitjen e pasurisë te paluajtshme Truall me Nr. pasurie.6/286 dhe sip.242 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.8513, Vol.24, Fq.102 e ndodhur në Rr"V.Kuqi", Lagjia 12, Durrës me vlerë fillestare ne ankand 67.200 EURO .  
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Permbirimore "E.G Bailiff Service" me përmbareues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 16.02.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I për shitjen e pasurisë te paluajtshme Ndërtesë me Nr. pasurie.6/56 dhe sip.108.24 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.8513.vol.31,fq.121 e ndodhur në Rr"V.Kuqi",Lagjia 12, Durrës me vlerë fillestare ne ankand 1.120 EURO .  
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Permbirimore "E.G Bailiff Service" me përmbareues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 02.03.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurisë te paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1000 m<sup>2</sup>, numër pasurie 294/33, Zona Kadastrale 3339, Volumi 11, Faqe 208 e ndodhur në Vrinë, Durrës në pronësi të Z.Ardian Rexhep Kola me vlerë fillestare ne ankand 1.764.000 LEKE.  
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

## HISTORIA

# PARIS 1978

## Beteja mes antikomunistëve dhe qeverisë komuniste për sheshin "Skënderbej"

*Dalin kabllogramet tepër sekrete, zbardhen përplasjet në Francë*

**M**e radiogramin e koduar "Tepër sekret" dhe numër 3387 të datës 26 tetor 1978 drejtuesi i Misionit të Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në Nju Jork njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë se "Gazeta "Liria" boton një letër të Lec Shllakut që thotë se ka siguruar nga bashkia e Parisit autorizimin që një sheshi t'i vihet emri "Skënderbeut" dhe se për këtë do bëhet një ceremoni".

Shtonte më pas: "Leci, me sa dimë, është i arratisur".

Pastaj Misioni Shqiptar në Nju Jork, gjithnjë referuar gazetës së botuar nga një pjesë e diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, thekson: "Ai ka ftuar "Lirinë" të marrë pjesë në ceremoni".

Në vijim e dhëna e vendndodhjes aktuale të autorit të shkrimit që: "Leci banon në 84 Rue de Fontaine, në Paris 16".

Në përfundim të këtij radiogrami tepër sekret dhe mjaft të shqetësuar për çfarë po ndodhte, qenë fjalët: "Ndoshta duhet ndërhyrë që veprime të tilla autoritet franceze të mos i bëjnë në bashkëpunim me këtë person".

### KUNDËRVEPRON TIRANA

Kjo që e dhëna e parë që po vinte në Tiranë për vendosjen e emrit të Gjergj Kastriotit të një sheshi në Paris. Nuk pati ndodhur asnjëherë më parë, qoftë në linjën e shërbimit diplomatik, qoftë edhe në atë të zbulimit politik shqiptar që punonte i kamufluar në ambasadën shqiptare në kryeqytetin francez, të merrej vesh kjo ngjarje.

Doemos në Tiranë pas kësaj qenë zënë në befasi. Diaspora antikomuniste, ajo kundër regjimit të Tiranës, me të cilën përlesheshin në vazhdimësi që pas 29 nëntorit 1944, ishte në prag të një fitoreje të saj politike, madje të bujshme.

E kishin mundur Partinë e Punës të Shqipërisë dhe vetë Enver Hoxhën me anë të Skënderbeut, kryeheroi kombëtar.

Rruga e vetme që prej këtij çasti të goditjes së bërë në piken e dobët të qeverisë së Tiranës, për këtë të fundit ishte kundërveprimi.

Të pasnesërmen, në 28 tetor 1978, me radiogramin e shifruar nr. 1409 Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë vuri në dijeni ambasadën e saj në Paris "se i arratisuri Lec Shllaku kishte mundur të siguronte autorizimin e Bashkisë së Parisit që një sheshi të t'i vihej emri "Skënderbej".

Në këtë radiogram urgjent udhëzohet ambasada "të interesohet për këtë çështje dhe të ndërhyjë pranë MPJ franceze për ta anuluar".

### RRITJE E TENSIONIT PËRPLASËS NË PRAG DITËS SË FLAMURIT

Mbetet shumë e pashpjegueshme se si ndodhi që Tirana e mori vesh nga "Liria", pra prej

Nju Jorkut, çfarë sfide në fushën patriotike po i bënte në Paris, në "syrin e botës", diaspora antikomuniste shqiptare jo vetëm e këtij qyteti dhe e tërë shtetit të Francës, e Belgjikës po ashtu, e cila bashkëpunonte intensivisht, por edhe ajo më e madhja e vendosur në shtetin e SHBA-ve.

Këtë herë kuptuan se me imazhin e Gjergj Kastriotit kundërkomunistët po mobilizonin kundër tyre gjithë bashkësinë, në fakt, tepër të përçarë politikisht, të të emigruarve shqiptarë që nuk e donin regjimin e Tiranës. Skënderbeu, gjykonin, mund t'ua forconte unitetin.

Kur Lec Shllaku e pati publikuar lajmin se kishin siguruar zyrtarisht të drejtën që një sheshi të Parisit t'i vihej emri zulumadh i Skënderbeut, që fundtëtori i motit 1978. Ndërkaq vendimi i Bashkisë së kryeqytetit francez (i Këshillit Bashkiak) bërë mbi propozimin e Komisionit të tij Kulturor, që i 10 korrikut. Ishte marrë, ndoshta për një simbolikë të rastë-

sishme, në përvjetorin e 100-të të Lidhjes së Prizrenit. Më pas, në betejën me Tiranën zyrtare, antikomunistët këtë hollësi do ta mësonin fort, si një element tjetër ngadhënjimtar mbi regjimin. Por nuk dhanë kurrë një provë se kombinimi ishte një aftësi organizimi i tyre.

Megjithatë siç të lë pa gojë se si asnjëri nga informatorët e njësish së zbulimit politik të shtetit të Enver Hoxhës nuk e kishte interceptuar këtë lajm sfidues, të habit edhe ritmi i plogët i dhënies së tij nga pala kundërshtarë. Sigurisht, për ta shmangur sa më tepër një përplasje me ambasadën dhe kokëfortësinë e faktit se Franca nën lëkurë ruante një lloj tolerance ndaj Hoxhës si kryetar shteti me kulturë filofranceze, nisimtarët e marrjes së autorizimit patjetër kanë zbatuar një lloj mosdërdëllitjeje të tepërt.

Në kuadrin e shkurtimit të kohës për ambasadën që të kundërvepronte, Lec Shllaku e shpalli pub-

likisht, me anë të një letre dërguar emigracionit kundërkomunist në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mes të tetorit dhe këta do ta botonin, siç bënë, në rastin më të parë. Patjetër edhe si një inkurajim për festën e madhe të një muaji më pas: 28 Nëntorit.

Por ndërkaq përhapje të lajmit për sigurimin zyrtar të së drejtës që në një shesh të Parisit, atje ku në vendimin e Bashkisë së Parisit thuhej se territori quhej "Villa Lumiere", do të emërtohej një shesh me emrin e Skënderbeut, e kreu edhe veprimtari antikomunist shumë i njohur Isa Ndreu, krahu i djathtë i Lec Shllakut (ose edhe e anasjella, sepse qenë një çift i pandashëm, dy shpirtra e dy mendje në një).

Ky jetonte në Firence dhe që botuesi dhe financuesi i revistës "Koha Jonë", një e ilustruar me cilësi të lartë teknike si edhe profesionalisht e mbushur me analiza mjaft të kualifikuara. "Koha Jonë" që media shqiptare e shkruar në emigracion me elitë e kohës (Për këtë ishte meritë e Lecit, intelektual dhe albanolog i vlerave të larta).

Isa Ndreu në "Koha Jonë" ditëve të para të tetorit 1978, ka



Në foto: Përrurimi i sheshit "Skënderbej" në Paris



shumë të ngjarë ende pa e publikuar lajmin në "Liria" Lec Shllaku, botoi një shkrim të tij, në të cilin mes të tjerash thuhej: "Edhe në Paris, në Kryeqytetin e Francës, do të kemi "SHESHIN SKËNDERBEG". Vendimi u muer prej Këshillit Bashkiak, i cili më datë 10 korrik 1978 dha pëlqimin e vet dhe vendosi që Sheshi AZ/19 të pagëzohet me emrin e Heroit tonë Kombëtar. Për të mbërri në këtë përfundim, që ka gëzue të gjithë Shqiptarët, janë dashtë gati dhjetë vjet, historikun e të cilit do ta botojmë në një vëllim të veçantë ma vonë".

Në vijim: "Nga letra që zoti Lec Shllaku, iu ka drejtue bashkëatdhetarëve, kuptohet se si janë zhvillue bisedimet dhe korrespondenca në mes Bashkisë dhe tij, dhe sa vullnet të mirë dhe durim i asht dashtë bashkëatdhetarit tonë, deri sa ia ka arritë qëllimit: me përjetësue kujtimin e Skënderbeut në Paris".

"Nga letra që zoti Lec Shllaku, iu ka drejtue bashkatdhetarëve, kuptohet se si janë zhvillue bisedimet dhe korrespondenca në mes bashkisë dhe tij, dhe sa vullnet të mirë dhe durim i asht dashtë bashkatdhetarit tonë, deri sa ia ka arrijtë qëllimit: me përjetësue kujtimin e Skënderbeut në Paris"



radiogram u shënu me shkrim dore ky udhëzim: Nr 3784, tuajit 1592. "Dakord të shkoni në Ministrinë e Jashtme juve vetë".

Radiogramin me këtë porosi MPJ e Tiranës, regjistruar me numrin 3784, ia nisi Dhimitër Lamanit në Paris. E udhëzonte që ai personalisht të merrte takim në MPJ franceze "dhe ta ngrinte edhe njëherë këtë çështje".

Në 27 nëntor 1978 ambasadori njoftonte eprorët: "Në mungesë të drejtorit mora takim të shtunën me zv.drejtorin e MPJ, z. Bochat, dhe i shtrova çështjen e emrit të sheshit Skënderbe, duke kërkuar që të anulohet çdo veprim me "kriminelët e arratisur". Ai tha se ju keni të drejtë dhe se do të përpqeshin si ministri pranë bashkisë, por pa na garantuar asgjë se bashkitë janë të pavarura. Na tha se do na përgjigeshin sa më shpejt si qëndron puna. Sot e hënë 28 Bochati më komunikoi se në 23 nëntor nuk do të bëhet asnjë ceremoni nga bashkia e Parisit dhe kjo është e konfirmuar. Njëkohësisht si më sugjeroi që të marrim pas disa ditësh me bashkinë për të parë mundësinë për bashkëveprim për emërtimin e ndonjë sheshi me emrin e Skënderbeut. Unë mendoj se anulimi është si efekt i ndërhyrjes tonë dhe më tutje do të shohim mundësinë tjetër".





**LAJMI DIVERSIV I RADIOS "ZËRI I AMERIKËS"**

Në 2 dhjetor 1978, ambasadës së Parisit i mbërriti nga Ksenofon Nushi radiogrami: "Radio "Zëri i Amerikës" njoftoi se me rastin e 28 Nëntorit "Kolonia Shqiptare" me Lec Shllakun në krye mundi të sigurojë lejen nga Shiraku dhe Komisioni Kulturor i Bashkisë së Parisit për të pagëzuar me emrin e Skënderbeut një shesh të Parisit. Ndërhyni përsëri dhe sqaroni çështjen. Presim".

Dy ditë më pas, në 4 dhjetor 1978, me radiogramin nr 1866, MPJ në Tiranë informohej nga ambasadori Lamanit se "Lidhur me çështjen e venies së emrit të një sheshi në Paris siç ju kemi njoftuar me ndërhyrjen tonë pranë MPJ dhe të kësaj pranë Bashkisë, kjo u anulua. Ne kontrolluam vendin dhe ky shesh është një qoshë e prapambetur e Parisit ku do të ishte shumë keq të vihej emri i heroit tonë përveç anës tjetër që kjo ishte iniciativë e larove që sillen në këto anë".

Në vijim: "Jemi të mendimit që në një kohë oportune ne të marrim kontakt vetë me Bashkinë e Parisit dhe të kërkojmë vënien e emrit "Skënderbe" të ndonjë sheshi apo rrugë të denjë për këtë emër dhe kjo të bëhet me ne që përfaqësojmë vendin tonë në Francë. Lutemi na njoftoni dhe presim mendimin tuaj".

Pesë ditë më vonë, në 9 dhjetor 1978, ambasadori i përgjigjej Tiranës: "Tuajit Nr. 3859. Nga të dhënat e nga kontaktet tona dhe nga verifikimi edhe njëherë në vend rezultoi se nuk është bërë asnjë ceremoni lidhur me "Skënderbenë". Pra, lajmi i dhënë është falloco dhe i bërë me qëllim për të larë faqen përpara njerëzve që janë mashtruar dhe të cilëve mund t'u kenë marrë edhe para.



**← MES BASHKISË SË PARISIT DHE JASHTMË SË MINISTRISË SË JASHTME FRANCEZE**  
 Pas radiogramit të shifruar të Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar ambasadës në Paris, bërë në 28 tetor, në datën 31, me radiogram 1491 ambasadori shqiptar ktheu këtë përgjigje: "Tuajit numër 3409. Morrëm kontakt me MPJ për problemin e emërtimit në Paris të "Sheshit Skënderbeg". Më thanë se nuk kanë dënuar dhe çështjen do ta shikojnë. Na thanë se mund ta bënit kërkesën edhe me notë, por meqë erdhët vetë, po mbajmë shënimin dhe do t'u njoftojmë".  
 Por ditët kalonin dhe në Tiranë prej përfaqësues të tyre diplomatike në Parisit nuk vinte asnjë njoftim për reagimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të vendit. Shënohej se ende nuk u kishin dhënë një përgjigje. Këtë gjendje pa rrugëdalje e sqaroi më në fund

radiogrami që iu dërgua Tiranës nga ambasadori. Ishte 23 nëntor. Mbante numrin 1592.  
 Në të komunikohet: "Lidhur me tuajin Nr. 3409. Me që deri sot nuk na u dha përgjigje nga MPJ franceze për sa i përket ceremonisë për dhënie e emrit të Skënderbeut një sheshi të Parisit me iniciativën e të arratisurve dhe të bashkisë së Parisit, sot Idajeti shkoi përsëri në MPJ për të marrë përgjigje. I thanë se do të përgjigjen sot ose nesër, por lanë të kuptohet se në disa raste bashkia e Parisit vetëvepron. Në këtë situatë mendoj të kërkoj vetë takim me drejtorin politik dhe të shtroj çështjen duke kërkuar që kjo ceremoni të mos bëhet, sepse Skënderbeu është hero i popullit shqiptar dhe jo i një grushti të arratisurish. Pres gjeje shpejt sepse nga disa të dhëna del se ceremonia mund të bëhet në 28 nëntor".  
 E firmosur nga nënministri i Jashtëm Ksenofon Nushi mbi këtë

Vetë lajmi siç e pamë në axhanset ishte i dyshimtë".  
 (Historia e betejës mes antikomunistëve të emigracionit politik shqiptar në Perëndim, veçanërisht atij të vendosur në Francë, dhe qeverisë komuniste të Tiranës zyrtare është tepër e gjatë në kohë dhe shkolluar prej vitit 1968 deri dy dekada më pas, ku një kulm tjetër e ka në motet 1980-1982, periudhë kur u krye ceremonia e vendosjes së emrit "Skënderbej" një sheshi të Parisit.  
 Vazhdimin dhe plotësimin e kësaj historie për lexuesin autori i këtyre radhëve do ta përmbushë së shpejti, por duke e mbyllur këtë pjesë të tërë intrigës së porsarrëfyer, ngul këmbë të saktësojë dy rrethana:  
 As Lec Shllaku dhe as Isa Ndreu nuk qenë të arratisur: I pari kishte ndjekur studimet e larta në Firence për pedagogji dhe në të njëjtën kohë i dyti po në këtë qytet

për filozofi. U diplomuan me rezultate të shkëlqyera universitare. Çlirimi i Shqipërisë i gjeti në Itali dhe ata, thjesht duke parë veprimet e regjimit të ri si edhe përndjekjeve që po u bënte familjeve të tyre, nuk u rikthyen më.  
 Personi i ambasadës që u ngarkua të shkonte në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës për të komunikuar qëndrimin zyrtar të qeverisë shqiptare ishte konsulli Idajet Hoxha, punonjëse me kontribut për rritjen e kontakteve kulturore mes Shqipërisë dhe Francës, shtimit të veprimtarive artistike dhe botimit të librave të autorëve shqiptarë. Ai që njëkohësisht edhe zbulues politik. Krahas dokumenteve nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, me burim atë, sepse jeton dhe kujtesën e ka në gjendje shumë të kthjellët, do të kemi rast më vonë të plotësojmë pamjen e kësaj ngjarjeje historike).

## Atentati ndaj kreut të SPO, flet bashkëpunëtori i tij

### Vrasja në Mitrovicë e Ivanoviçit, Jaskiç: Do të më vrasin edhe mua



Bashkëpunëtori i politikantit të ndjerë Oliver Ivanoviç, Marko Jaskiç

Bashkëpunëtori i politikantit të ndjerë Oliver Ivanoviç, Marko Jaskiç ka shkruar ndër të tjerash se: "Unë nuk kam pasur frikë nga vdekja. Pas asaj çfarë i ndodhi Oliverit, po mendoj për të njëjtën gjë dhe kam frikë vetëm se nuk do të mund të shkruaj më këtu, se kush dhe pse më vrau prapa shpinës". Ky i fundit nuk ka dhënë ndonjë detaj më tepër nëse ka marrë ndonjë kërcim me

**NGJARJA**

Oliver Ivanoviç i qëllua për vdekje mëngjesin e 16 janarit 2018 në Mitrovicë teksa po hynte në ambientet e partisë së tij. Sipas njohimit të Ksenija Bozovic nga 'GI SDP', policia gjeti tri plumba para zyrës së Ivanoviçit. Një njeri i panjohur qëlloi me pistoletë në drejtim të tij me një armë me silenciator nga një makinë në lëvizje.

vdekje. Megjithatë, ky nuk është mesazhi i parë dhe i vetëm i një prej personave publikë të pjesës së Mitrovicës së Veriut. "Sot isha në 'takim' me Vuçiçin, si një anëtar i opozitës. Prisja të thirresha dhe u përgatita të

bëja pyetje, por hoqa dorë, sepse nuk kishte aparate fotografike dhe kisha frikë. Nga 250 veta në sallë, ishte vetëm njëri që qëndronte i ulur dhe nuk duartrokiste kur udhëheqësi ynë hyri. Unë kaq kam mundur dhe kam pasur guxim të bëja", shkroi më 20 janar, pas një takimi prapa dyerve të mbyllura në Fakultetin Teknik në Mitrovicën e Veriut me Presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ku ishin

prezentë anëtarët e Listës Serbe dhe kërret e institucioneve që duartrokisnin. Marko Jaskiç gjatë zgjedhjeve lokale në Kosovë, në fund të tetorit të vitit të kaluar ishte në listën e Iniciativës Qytetare të Oliver Ivanoviç, (SPO) dhe u bë këshilltar në Kuvendin Komunal të Mitrovicës Veriore.

Zëdhënësi Michalis Patsikas: Lëvizja më madhështore që keni parë, 1 milion në shesh

# Emri i Maqedonisë, Greqia në protestë

Marshuesit: Në shesh do të derdhet gjak, qeveria të mos bëjë kompromis

Ditën e djeshme organizatorët në Greqi kanë premtuar se do të mbajnë një protestë në Athinë, për t'i bërë thirrje qeverisë që të mos bëjë kompromis në kontestin e emrit që ka ky vend me Maqedoninë. Zëdhënësi i marshit, Michalis Patsikas, u ka thënë gazetarëve se protesta do të jetë "madhështore dhe diçka që nuk ka ndodhur kurrë më parë". "Do të dergojë mesazh të qartë brenda dhe jashtë Greqisë", ka thënë Patsikas, duke shtuar se pritet që rreth 1 milion persona të mbledhen afër sheshit "Syntagma" në kryeqytet. Greqia përballet prej një kohe të gjatë me konfliktin për emrin "Maqedonia" me vendin fqinj. Kjo ndodhi pas Maqedonia fitoi pavarësinë më 1991. Liderët e të dy vendeve kanë thënë se kanë arritur përparim në zgjidhjen e problemit, duke përmendur shtimin e ndonjë prej parashesave "e madhe", "e re" apo "veriore" në emrin e Maqedonisë. Negociatori i Kombeve të Bashkuara, Matthej Nimetz ka shprehur optimizëm për vendet fqinje të Ballkanit duke përmendur këtë vit si kohën e zgjidhjes së kontestit. Protesta në Greqi do të jetë e dyta në pak javë për këtë çështje. Ato janë duke u organizuar dhe financuar nga grupe greke të diasporës, të përkrahur nga zyrtarë të pensionuar, grupe të kishave dhe disa tjera. Më 21 janar në Selanik ishin mbledhur mijëra protestues, pikërisht për çështjen e emrit. Policia ka deklaruar se në protestë kanë qenë 90,000 persona, ndërsa organizatorët kanë pretenduar të kenë qenë 400,000 protes-



Greqia në protestë

tues. Ndërkohë që nga ana tjetër ende nuk kanë arritur asnjë nga palët të marrin një

vendim lidhur me emrin e Maqedonisë. Organizatorët e cilësojnë këtë si mani-

festimi më i madh i 20 viteve të fundit. Që në orët e para të mëngjesit të

## ORGANIZIMI

Protesta në Greqi do të jetë e dyta në pak javë për këtë çështje. Ato janë duke u organizuar dhe financuar nga grupe greke të diasporës, të përkrahur nga zyrtarë pensionistë, grupe të kishave dhe disa të tjera.

sotëm, qindra autobusë vërshuan drejt kryeqytetit Athinë, të mbushur me protestues, por dhjetëra të tjerë mbërritën edhe në trenat dhe tragetet nga Pireu. 5000 forca policore do të kujdesen për mbarëvajtjen e protestës dhe shmangien e incidenteve. Në një kohë kur forcat politike në vend, sikurse edhe sinodi i kishës, kanë bërë thirrje për vetëpërmbytje, grupet anarkiste që janë kundër këtij manifestimi kanë kërcënuar me gjakderdhje.

## Ministri Popoviç: Zgjidhja përfundimtare është autonomia

### Daçiç: Po na bëjnë presion të njohim Kosovën, por s'do ta pranojmë kurrë



Ivica Daçiç, ministri i Jashtëm serb

Ivica Daçiç, ministri i Jashtëm në Serbi, ka thënë edhe një herë se shteti serb nuk ka asnjë gjasë ta pranojë pavarësinë e Kosovës. Por, ai ka deklaruar se janë të gatshëm për një kompromis, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje historike. "Ne duam që të arrijmë një kompromis me Kosovën, por nuk mund ta miratojmë shkëputjen e njëanshme të tyre", deklaroi ministri serb, transmeton "Iajmi.net". Ai kritikoi shtete e mëdha që sipas tij po i bëjnë presion Serbisë ta njohin pavarësinë e Kosovës. "Si mund të mos u

**DEKLARATA**

Para tri ditësh, Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka deklaruar se nuk do ta "fusë kokën në rërë siç kanë bërë tjerët" kur është fjala për Kosovën, raportojnë mediat serbe. Ai ka shtuar se është i gatshëm për kompromis, por ka porositur se nëse dikush mendon që Serbia do t'i japë të gjitha dhe të mbetet pa asgjë, mashtrohet keq.

vijë turp që të na propozojnë një gjë të tillë?! Ne u kemi treguar se marrëveshja është e domosdoshme me Kosovën, por kjo nuk do të thotë se e njohim pavarësinë", ka theksuar Ivica Daçiç. "Kosova kurrë nuk do të bëhet e pavarur, sepse Serbia ka miq në anën e saj, e mbi të gjitha Rusinë dhe Kinën", ka përfunduar ministri serb, Ivica Daçiç. Ndërkohë që një ministër tjetër serb, Nenad Popoviç ka thënë: "Një autonomi shumë e gjerë për shqiptarët, por nën kujdesin e Kushtetutës serbe dhe Rezolutës 1244, është zgjidhja përfundimtare për problemin e Kosovës". Ai është shprehur se autonomia për

Kosovën do të ishte edhe në interesin e të gjithë shqiptarëve. "Është e rëndësishme që të gjithë së bashku, pavarësisht nga dallimet politike, të japim zgjidhjet tona. Unë nuk i kuptoj ata që nuk duan të marrin pjesë në dialog", ka thënë për "Blic" ministri serb për Zhvillim dhe Inovacion, Popoviç. Këto propozime nga pala serbe vijnë tani kur Kosova po përgatitet për të festuar 10-vjetorin e shpalljes së pavarë-

sisë. Ndërsa para tri ditësh, Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka deklaruar se nuk do ta "fusë kokën në rërë siç kanë bërë tjerët" kur është fjala për Kosovën, raportojnë mediat serbe. Ai ka shtuar se është i gatshëm për kompromis, por ka porositur se nëse dikush mendon që Serbia do t'i japë të gjitha dhe të mbetet pa asgjë, mashtrohet keq.




## "SIMPTOMAT QË SHFAQIN PACIENTËT"



Ylli Merja:  
Si të shkrihi gurët  
në veshka me  
bimët mjekësore

## ILAÇ MAGJIK



Trajtoni  
depressionin  
me vaj  
peshku

# Orges Spahiu:



🔴 Mjeku i QSUT-së: Dita Botërore  
në Luftën Kundër Kancerit,  
sensibilizim opinionit publik

# Alarmi, 7 mijë raste të reja me kancer çdo vit

"Pacientët paraqiten në stade  
të avancuara të sëmundjes"

• 10 këshilla për dhëmbë sa më të bardhë plot shkëlqim. Efektet çudibërëse të aloe verës

Mjeku i QSUT-së: Dita Botërore në Luftën Kundër Kancerit, sensibilizim opinionit publik

# Orges Spahiu:

## Alarmi, 7 mijë raste të reja me kancer çdo vit

### "Pacientët paraqiten në stadi të avancuara të sëmundjes"

Voltiza Duro

**K**anceri njihet si rritje e pakontrolluar e qelizave, që prodhojnë 1 tumor ose neoplazme dhe shifrat e të prekurve nga kjo sëmundje po pësojnë një rritje të frikshme nga viti në vit. Në vendin tonë aktualisht kemi mbi 7000 raste të reja të diagnostikuara me kancer në vit. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku i Shërbimit Onkologjik në QSUT, Orges Spahiu tregon se në bazë të një analize 5-vjeçare, është vërejtur një rritje me rreth 60% të personave të prekur nga kanceri. Mjeku më tej bën thirrje që të kryhen të gjitha diagnostikimet e nevojshme në mënyrë që sëmundja mos të kapet në stadin e fundit.

#### Çfarë simbolizon Dita Botërore e Luftës Kundër Kancerit?

4 shkurti është Dita Botërore e Luftës Kundër Kancerit, një iniciativë ku e gjithë bota bashkohet në luftën kundër kësaj epidemie globale. Dita botërore e luftës kundër kancerit ka si qëllim të parandalojë çdo vit miliona vdekje, duke rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin për sëmundjen e kancerit dhe duke nxitur qeveritë dhe individët nëpër botë të veprojnë kundër kësaj sëmundjeje.

#### Si paraqiten shifrat e të sëmurëve nga viti në vit?

Vitet e fundit sëmundja e kancerit ka treguar një rritje të ndjeshme të inci-

dencës, pra pacientët me kancer po shtohen dita-ditës. Alarmant është fakti se kanceri në dekadat e ardhshme pritet të rritet, duke u dy apo trefishuar. Numri i rasteve të reja të diagnostikuara me kancer në botë pritet të rritet me 70% në dy dekadat e ardhshme, duke vlerësuar se në 2030 numri vjetor global i të diagnostikuarve me kancer do të arrijë në rreth 23.6 milionë njerëz.

#### Po në Shqipëri si paraqitet situata?

Në vendin tonë aktualisht kemi mbi 7000 raste të reja të diagnostikuara me kancer në vit. Ndërkohë nga një analizë 5-vjeçare është vërejtur një rritje mesatare me rreth 12% në vit, ose një rritje me rreth 60% për 5 vitet. Kjo për arsye tashmë të njohura

#### Cilat janë kategoritë më të predispozuar për t'u prekur nga kanceri?

Vlen të theksoj se më së tepërmi, pra 4 nga 10 raste të diagnostikuara me kancer ndeshen në vende me të ardhura të ulëta ose mesatare, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Gjithashtu vlerësohet se rreth 70% e vdekjeve nga kanceri ndodhin në këto vende.

#### Në cilin stad të sëmundjes paraqiten pacientët te mjeku?

Karakteristikë e të sëmurëve me kancer në vendin tonë është diagnostikimi apo paraqitja tek mjeku në stadi të avancuara të sëmundjes. Ky fakt përbën një sfidë shumë të madhe në luftën me këtë sëmundje, duke reduktuar në mënyrë domethënëse



që variojnë nga ndotja e mjedisit tek stili i jetesës, abuzimi me alkoolin dhe kequshqyerja, jeta sedentare, obeziteti etj. Falë studimeve dhe kërkimeve intensive të vazhdueshme, janë bërë përpertime të mëdha në diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit.

shanset e kurimit tek pacientët tanë.

#### Cilat janë faktorët e diagnostikimit në stadi të avancuara të sëmundjes?

Paraqitja tek mjeku në stadi të avancuara të sëmundjes ndodh për shkak të një



Mjeku Orges Spahiu

ndërgjegjësimi dhe edukimi të ulët të kujdesit mjekësor tek popullsia jonë. Në këto kushte del si prioritet kombëtar një ndërmarrje gjithëpërfshirëse për ndërgjegjësimin dhe edukimin mjekësor të popullatës mbi rrezikun e kancerit dhe rëndësinë e përfitimit nga diagnostikimi i hershëm i kësaj sëmundjeje. Një rol thelbësor dhe përgjegjësi sociale i mbetet medias, e cila në bashkëpunim me mjekët specialistë të kësaj fushe përbën potencialin më të mirë për ndërgjegjësimin e popullsisë sonë për rrezikun ndaj kancerit. Ndërkohë, gjithsecili që mund të jetë i përfshirë në një mënyrë apo tjetrën në luftën kundër kancerit mund të kontribuojë në këtë kauzë. Të mbljetuarit nga kanceri janë potenciali më i mirë për të ndërgjegjësimin dhe edukimin shëndetësor të popullsisë për t'i kushtuar përpjekjet dhe edukimin e nevojshme rrethikun ndaj kancerit duke kryer ekzaminime fizike, kontrole rutinë - checkups, vetë-ekzaminimin dhe testet diagnostike për të mundësuar zbulimin e hershëm të kancerit.

#### Si mund të bëhet parandalimi i kancerit?

Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm është thelbësor për kontrollin e kancerit. Parandalimi ka të bëjë kryesisht me evitimin e faktorëve të rrezikut siç janë duhanpirja, abuzimi me alkoolin, stili i jetesës dhe ekspozimi ndaj ndotësve apo karcinogene ambientale. Diagnostikimi i hershëm është i lidhur ngushtë me ndërgjegjësimin dhe edukimin shëndetësor të popullsisë për t'i kushtuar përpjekjet dhe edukimin e nevojshme rrethikun ndaj kancerit duke kryer ekzaminime fizike, kontrole rutinë - checkups, vetë-ekzaminimin dhe testet diagnostike për të mundësuar zbulimin e hershëm të kancerit.

#### Si realizohet vetë-ekzaminimi?

Ekzaminoni veten për ndry-

shime në lëkurën tuaj si dhe kontrolloni pjesën e brendshme të gojës suaj duke u parë në pasqyrë. A vini re ndonjë ndryshim të ngjyrës së mishit të dhëmbëve, gjuhës dhe pjesëve të tjera të gojës? A shihni pllakëza të bardha, ënjtje apo gjakosje? Nëse ndeshni një ose disa shenja të tilla në trupin tuaj, kontaktoni menjëherë mjekun tuaj.

#### Kur duhet t'i nënshtrohet mamografisë një grua?

Edhe nëse një grua duket e shëndetshme, ajo duhet t'i nënshtrohet mamografisë për të testuar një kancer të mundshëm të gjirit. Mamografia konsiderohet testi ekzaminues më efikas për këtë problem shëndetësor. Ndërkohë, nënshtrojuani ekzaminimeve të rregullta fizike. Mjekët e dinë se kontrolli i trupit duhet të kontrollojë për të evidentuar probleme të mundshme shëndetësore. Më tej ju duhet t'u nënshtroheni kontrolleve rutinë për t'u siguruar që gëzoni një shëndet të mirë do të donit të kontrolloheshit apo nga i cili mund të kërcënoheni më shumë.

#### Si bëhet diagnostikimi i kancerit të prostatës?

Shumë lloje kanceri (si kanceri i prostatës) nuk tregojnë shenja lajmëruese derisa sëmundja përpëron. Kanceri i prostatës diagnostikohet herët nëpërmjet testit të antigenit specific (PSA). Probabiliteti që një mashkull të ketë këtë sëmundje rritet në raport të drejtë me nivelin e PSA-së (niveli normal është 4ng/mL).

Voltiza Duro

**G**urët në veshka janë de pozitim i mineraleve dhe kriepërave në brendësi të mureve të veshkave. Si fillim, ato grumbullohen në kristale që ngjiten dhe më pas formojnë gurët në veshka. Vendi ku formohen gurët e veshkave janë vendet ku segmentet tubulare bashkohen në tubulin përmbledhës kortikal. Në këto tubula përmbledhëse bëhet bashkim i jo vetëm i urinës, por edhe i këtyre kristaleve dhe në rastet kur personi nuk përdor shumë ujë gjatë ditës nga 1 deri 1.5 litra ujë, atëherë është mundësia që këto kristale të bashkohen dhe të formojnë mikrokalkula. Substancat që formojnë gurët janë acidi urik, kalciumi dhe oxalate. Formimi i gurëve në veshka është gjenetike, nëse prindërit tuaj vuajnë nga formimi i gurëve në veshka, atëherë duhet të konsumoni sa më shumë lëngje, pasi ju keni probabilitet të lartë për të pasur gurë në veshka.

**Llojet e gurëve në veshka**

Gurët e shkaktoar nga grumbullimi i acidit urik shkaktohen në rastet e mungesës së lëngjeve në organizëm. Këto formohen kur nuk konsumojmë lëngje mjaftueshëm, kur dehidratohet organizmi ose kur konsumojmë shumë proteina në dietën tonë. Këto lloje gurësh në përgjithësi janë gurë mesatarë për nga forhtësia. Në varësi të madhësisë shkrihen për 2,3 apo 4 javë.

Cistina është lloj guri që formohet tek personat që organizmi i tyre sekretion shumë aminoacide në cistinuri në veshka dhe është e trashëguar. Këto lloje gurësh janë të fortë, me pamje qelqore, të errët. Shkrihen me vështirësi dhe kërkojnë një kohë të gjatë.

Oksalate Kalciumi formohen më së shumti nga dijeta ushqimore. Oxalatat vijnë nga frutat, perimet, farat e ndryshme dhe depozitohen në veshka. Këto lloje gurësh shkaktohen edhe nga përdorimi i tepërt i ilaçeve farmaceutike.

Minerali Struvite shkakton gurë në veshka kronike. Kalkulat që formohen nga këto lloje gurësh janë të mëdha dhe shumë të vështira për t'u luftuar.

**Simptomat**

Gurët në veshka nuk japin dhimbje kur formohen, pasi ato formohen në "xhepa" ose në vende që nuk lëvizin dhe ndihen vetëm kur kanë arritur përmasë të konsiderueshme. Ato ndihen kur lëvizin nga vendi ose tronditen pasi kemi konsumuar shumë birrë, ose ujë. Gurët në veshka shkaktojnë dhimbje në pjesën e mesit, në të dyja anët e shtyllës kurrizore poshtë brinjëve. Nëse gurët janë në uretër apo kanalet urinare, atëherë ato shkaktojnë dhimbje në pjesën anësore të trupit dhe në fund të barkut. Shpeshherë gurët në veshka kur lëvizin, gërvishin muret anësore të kanaleve dhe kjo shkakton që urina të jetë me ngjyrë të kuqe të lehtë ose të errët. Nëse urinimi është i ndërprerë ose me sasi të vogla kjo vjen si pasojë e infeksionit ose gurëve në veshka.



Mjeku popullor: Konsumoni shumë lëngje dhe mbani një dietë të ekuilibruar

# YLLI MERJA: Si të shkrini gurët në veshka me bimët mjekësore

*"Simptomat kryesore që shfaqin pacientët"*



Mjeku popullor Ylli Merja

**Trajtimi**

Nëse konsumoni shumë lëngje dhe nëse përdorni një dietë të ekuilibruar, atëherë ju do të gëzoni shëndet të plotë. Për individët që janë më të rrezikuar, këshilla ime është të konsumoni sa më shumë lëngje, ujë dhe çajëra që përmbajnë vitaminën C. Molla e egër e trëndafilii i egër janë çajra të këndshëm që përmbajnë vitaminë C me shumicë dhe shumë vitaminë të tjera që ndihmojnë në shkrirjen e gurëve në veshka, e

pastrimin nga bakteret në rrugët urinare. Krahas frutave që përmbajnë acide organike, po ju rekomandojmë edhe disa bimë që përmbajnë acide organike dhe ju ndihmojnë që të shkrini gurët në veshka. Është shumë i njohur përdorimi i fierit të gurit ose gjarpriit mjekësor. Majdanozi i egër apo Adiantum capillus veneris, ashtu si dhe fieri i gurit rritet në shkëmbinj e është përdorur tradicionalisht për veshkat. Lënda aktive që ndodhet në kërcellin dhe në gjethet e

kësaj bime si acidet triterpenoike dhe acide të tjera organike ndihmojnë me së miri këtë proces. Edhe rrenja e gramit (Cynodon dactylon) ndihmon në shkrirjen e gurëve në veshka pasi përmban triticine dhe nga prania e saponinave në rrenjën e gramit bëjnë që kristalet gjatë shkrirjes të rrëshqasin në kanalën e uretërit me pak dhimbje. Një tjetër bimë që ndihmon në shkrirjen e gurëve në veshka është edhe

këputja (Equisetum arvense), që përmban acid salicilik 5-8% bioflavonoide, saponina etj. Ndërkohë edhe mustaqet e misrit (Maydis stigma) përmbajnë gliceride të acideve linoleik, oleik, linolenik, cerotik, laurik, palmitik, stearik e kanë fuqi vepruese më të madhe kur kokrrizat e pjalmiit nuk kanë rënë mbi to. Nga të gjitha këto bimë që përdoren më lart është mirë që nëse përdoren në veçanti të përgatiten në këtë mënyrë: Përafërsisht në 2 litra ujë mund të ziejmë për 2-3 minuta nga 10-15 gramë me secilën bimë dhe ky çaj nga të rriturit pihet gjatë gjithë ditës. Nga kjo sasi çaji përdoruesi merr nga 75 - 100 mg acid organik në ditë, që ky fillon të hyjë në reaksion me gurin në veshka. Krahas shumë produkteve të tjera natyrale siç janë dhe frutat e murizit, fara e prarit, farat e gjembaçit, lulja e amit, ne kemi kompozuar edhe një përzierje bimore, e cila prej vitesh ka treguar se funksionon shumë mirë në drejtim të shkrirjes së gurëve në veshka dhe të infeksioneve urinare. Nga kjo përzierje bimore mund të marrim 7-8 lugë gjelle dhe t'i ziejmë në 2 litra ujë për 2-3 minuta. Është mirë që pasi kanë dalë gurët, personi 3-4 muaj pasi guri është shkrirë, të përdorë nga një pako në muaj nga çaji i veshkave. Kjo do ta ndihmonte që aty ku ka qenë vendi i gurit të mëparshëm "zgavra" të jetë zhdukur plotësisht, pra tubuli përmbledhës i urinës të mos të na rikrijojë gurë të ri.

**N**jë rol tejet të rëndësishëm për një buzëqeshje sa më të bukur luajnë edhe dhëmbët e bardhë. Këta të fundit, sipas studimeve, i japin njeriut më tepër vetëbesim, por shpeshherë konsumimi i ushqimeve të ndryshme, pirja e duhanit e shumë faktorë të tjerë ndikojnë në prishjen e dhëmbëve. Më poshtë po japim disa këshilla të vlefshme për një buzëqeshje të mrekullueshme e dhëmbë që shkëlqejnë.

**Lani me kujdes dhëmbët**

Kushtojini vëmendje përdorimit të fillit dentar në mbrëmje dhe lani dhëmbët për 2/3 minuta, 2 herë në ditë. Përdorni një furçë me qime të buta dhe përdorni të paktën një herë në ditë fillin dentar. Përdorni shpëlarës goje të fluorizuar përpara periudhës së gjumit.

**Konsumoni fruta dhe perime**

Molla, dardha, luleshtrydhet, selino dhe karotat do të mund t'ju ndihmojnë që të kenë dhëmbët sa më të bardhë. Nëse do t'i fërkonit dhëmbët çdo mëngjes me luleshtrydhe, atëherë kjo do t'ju ndihmojë të hiqni njollat.

**Pini sa më shumë ujë**

Uji është ideal për dhëmbët të bardhë. Konsumimi i

# 10 këshilla për dhëmbë sa më të bardhë plot shkëlqim



ujit pas ushqimit, ndihmon në parandalimin e njollave.

**Mos përdorni furçën të fortë**

Një furçë dhëmbësh duhet të ndërrohet mesatarisht çdo 3 muaj. Shpëlarja e gojës me ujë pas

vakteve ka pak efekt mbi acidet bakteriale, megjithëse mund të ndihmojë në eliminimin e mbeturinave ushqimore. Fërkimi i vazhdueshëm i dhëmbëve me furçën të fortë mund të shkaktojë probleme afatgjata tek dhëmbët, pasi i dobëson ato nga mbrojtja e tyre natyrore.

**Mos pini duhan**

Të lini duhanin mund të duket e vështirë për t'u arritur, por në të vërtetë sjell përfitime maksimale në kujdesin për dhëmbët, duke i mbajtur të shëndetshëm e të bukur e duke evituar zverdhjen e tyre.

**Mos e topmoni me kafën**

Gjithashtu, duhet të mundoheni që të reduktoni edhe teprimet me kafën gjatë ditës. Shumë njerëz kanë dëshirë që të

konsumojnë disa kafe gjatë ditës, por nuk e dinë që kafja është një armik për dhëmbët. Por kjo nuk do të thotë që ne të heqim dorë dhe të mos pimë kafën, thjesht të mos e teprojmë me të.

**Shkoni te stomatologu**

Për të mbajtur larg problemet të cilave iu referuam në fillim duhet të dimë që vizita e parë te dentisti, e cila më pas duhet të jetë periodike duhet të kryhet çdo 6 muaj dhe duhet të fillojnë që në moshën 6 muajsh, kohë në të cilën nis dhe dalja e dhëmbëve të parë. Kjo rutinë nuk duhet ndërprerë më pas. Profilaksia ose e thënë ndryshe parandalimi është forma më e mirë dhe më e rëndësishme në parandalimin e këtyre problemeve, që kanë të bëjnë me prishjen e dhëmbëve, si dhe më ndalimin e procesit karioz.

**Mos konsumoni pije të gazuara**

Shumë pije të gazuara të cilat janë në treg nuk janë aspak aleate besnike për zbardhjen e dhëmbëve. Acidet që ato përmbajnë si ai fosforik, citrik e "zhveshin" smaltin.

**Pini lëng limoni**

Lëngu i limonit është një përbërës mjaft i mirë natyral kundër njollave joestetike të verdha të shkaktuara sidomos nga pirja e duhanit, por edhe nga kafja.

**Largoni furçën nga tualeti**

Tualeti nuk është vendi më i mirë për të ruajtur një furçë dhëmbësh dhe, bulojeni gjithnjë për të shmangur kontaktin me mikrobet.





# Këshilla



## Trajtoni depresionin me vaj peshku

Vaji i peshkut është konsideruar gjithmonë si një ilaç magjik për shumë sëmundje, por sipas studimit të ri, konsumi i tepruar rrit rrezikun e prekjes nga kanceri i prostatës. Kapsulat e vajit të peshkut prodhohen nga vajrat dhe yndyra e nxjerrë nga peshqit, kryesisht nga salmoni, sardelet dhe skumbri. Këto vajra dhe yndyra përmbajnë kryesisht acide yndyrore Omega3, të cilat janë shumë të rëndësishme për funksionimin siç duhet të organizmit. Omega3 luan një rol të rëndësishëm në sëmundjet e zemrës, trajtimin e inflamacionit, përmirësimin e funksionit të trurit. Shumë studime kanë treguar se vaji i peshkut ka një efekt pozitiv në trajtimin e simptomave depressive deri në 30%. Studime të tjera kanë treguar se vaji i peshkut ka ndikim pozitiv në çrregullime të tjera si çrregullimi bipolar. Sipas statistikave, 1 në 3 të rritur vuan nga tensioni i lartë i gjakut. Konsumimi i vajit të peshkut është një nga mënyrat më të mira për të ulur presionin e lartë të gjakut. Acidet yndyrore Omega3 dhe

Omega6 ndihmojnë në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Gjithashtu, vaji i peshkut ul nivelin e lartë të triglicerideve në 20%, e rrit nivelin e kolesterolit të mirë që nuk dëmton organizmin. Ndikimi i vajit të peshkut në këtë gjendje është i dukshëm pas disa muajsh përdorimi të rregullt. Acidet yndyrore Omega3 kanë veti anti-inflamatore dhe mendohet se vaji i peshkut është mënyra më e mirë për

ta parandaluar dhe trajtuar këtë sëmundje. Konsumimi i rregullt i tij mund të zvogëlojë simptomat e osteoartritit dhe artritet reumatoid. Ndërkaq, vaji i peshkut rigjallëron lëkurën e plakur duke shtuar prodhimin e kolagjenit dhe elastineve që dhurojnë freski. Më tej, nënat që marrin suplement të vajit të peshkut kanë rrezik më të vogël të lindjes së hershme.



## Efektet çudibërëse të aloe verës

Bima aloe vera përmban mbi 75 lloje lëndësh të dobishme, vitamina, minerale, enzima, sheqer, përbërës fenolik dhe aminoacide e përdorimi i saj jep efekte çudibërëse në organizmin e njeriut. Në këtë bimë gjenden antioksidantë në nivele të larta që luftojnë radikalet e lira në trupin tonë, duke i neutralizuar dhe duke parandaluar të rëndojnë sëmundje si kanceri. Moshë e bimës së aloe verës ka po ashtu rëndësi në luftën që kjo bën ndaj radikaleve të lira. Sa më e vjetër të jetë bima, aq më e dobishme është. Ndërkaq, aloe vera përmban tetë lloje të ndryshme enzimash që bëjnë mrekulli për tretjen. Veçanërisht, enzimat që ndodhen tek aloe vera ndihmojnë në copëtimin e sheqerit dhe yndyrave, të cilat shkaktojnë probleme në tretje. Më tej kjo bimë përmban 10 prej



mineraleve më të fuqishme që i duhen lëkurës si kalciumi, kromi, bakri, hekuri, magnezi, mangani, fosfori, natriumi dhe zinku. Ndaj përdoreni këtë të fundit për të pastruar fytyrën, në mënyrë që të dukeni përherë të reja dhe me lëkurë të shkëlqyeshme. Aloe vera mund t'ju ndihmojë edhe në zhdukjen e akneve, pasi zinku redukton yndyrën natyrore që prodhon vetë lëkura. I ftohti shpesh shkakton sëmundjen e shkatërrimit të qelizave, duke sjellë kështu dëmtimin dhe hapjen e plagëve të pjesëve më të ekspozuara të trupit, por aloe vera ul nivelin e trimboksanës, lëndës që shihet si shkaktarja e dëmit. Aloe vera ndihmon edhe në luftën kundër agentëve tumoralë. Sipas një studimi japonez, nëse lëngun e aloe verës e përdorim në formën e xhelit, kjo ndihmon në parandalimin e kancerit të stomakut dhe zorrës së trashë. Ndërkohë, aloe vera ndihmon në rritjen e flokëve të shëndetshëm duke rritur qarkullimin e gjakut në skalp. Enzimat përbërëse i japin aloe verës mundësinë të jetë një lëndë e dobishme për balancimin e peshkës në kokë.

# PRONARET TOKAT

Kompensimi fizik merr përparësi, do të shpërndahen 23 mijë hektarë

Ornela Manjani

Pas hyrjes në fuqi të vendimit të qeverisë, i cili jep përparësi kompensimit fizik të ish-pronarëve, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përditësuar listën me toka të lira. Tokat e lira janë arë ullahte, pemtore në Berat, Elbasan Gjirokastër dhe Korçë. Në total janë 23 400 parcela me një sipërfaqe të përgjithshme rreth 23 mijë hektarë dhe me vlerë 37,1 milionë lekësh. Për të përfutur tokat e lira mund të aplikojnë pronarët për të cilët ka përfunduar procesi i njohjes dhe vlerësimit të pronës dhe konkretisht ato ish-pronarë që aplikuar në AKKP në vitet 1993, 1994, 1995 dhe 1996.

**LIGJI**

Në ankandin për kompensimin fizik nuk do të marrin pjesë pronarët, të cilët kanë paraqitur dosjet për kompensim nga viti 1993 deri në vitin 1996. Në rastin e kompensimit me ankad nuk ndiqet rendi kronologjik i vendimit. Agjencia e pronave nxjerr në faqen e saj zyrtare pronat, të cilat do të nxirren në ankad për ish-pronarët dhe 20 ditë pas këtij njoftimi, pronarët duhet të dorëzojnë aplikimin në Agjenci. Kjo e fundit brenda 10 ditëve duhet të marrë vendim për shpalljen e fituesit. Aplikimi bëhet nga të gjithë pronarët që kanë një vendim përfundimtar, i cili ka njohur të drejtën për kompensim. Si rregull

# Ish-pronarët, ATP: Tokat e lira, ja kush përfiton

*Përfitojnë dosjet e viteve 1993, 1994, 1995 dhe 1996*

duhet që vendimi për kompensim të ketë edhe vlerën financiare. Pra, pronarët i njihet një sipërfaqe toke e zënë, me një vlerë financiare prej x lekësh. Por qeveria është e interesuar të kryejë kompensimin me ankad, ndaj në vendimin e saj parashikon që edhe kur pronarët nuk kanë një vlerësim financiar të pronës së njohur, mund të marrin pjesë. Në fondin e pasurive të paluajtshme, që mund të përdoren për kompensim fizik, bëjnë pjesë sipërfaqe toke, pronë shtetërore, të cilat nuk ushtrojnë funksion publik. ATP-ja mund të përdorë për kompensim fizik me pronë shtetërore pasuri, të cilat, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, figurojnë në

pronësi të shtetit dhe plotësojnë, të paktën, njërën nga kushtet e mëposhtme: a) Toka të ndodhet ndërmjet ose ngjitur pronave/pronës së kthyer me vendim përfundimtar administrativ apo gjyqësor; b) Toka të mos ketë asnjë funksion publik; c) Toka të mos ketë vlerë më të madhe sesa vlerësimi i tokës së njohur për kompensim; ç) Toka, fizikisht, me vërtetimin e organit kompetent për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, nuk prekan infrastrukturën apo ndonjë zhvillim publik të ardhshëm. Subjektet e interesuar, të cilët disponojnë një vendim përfundimtar që ka njohur të drejtën e kthimit dhe kompensimit të pronës, që të përfitojnë ko-

mpensim fizik, sipas këtij kreu, duhet të paraqesin: a) kërkesën për kompensim fizik me pronë shtetërore, pranë ATP-së; b) sipas rastit, vendimin përfundimtar të ish-AKKP-së, ish-ZRKKP-së, ish-KKKP-së apo vendimin gjyqësor përkatës, që njeh të drejtën e kthimit dhe kompensimit të pronës, shoqëruar me planvendosjen e vendimit; c) vërtetimin nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për statusin juridik të pronës që kërkohet, shoqëruar me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese; ç) vërtetimin nga bashkia se sipërfaqja e tokës, sipas studimit dhe/ose gjendjes faktike, nuk ka funksion publik.

**TOKAT E LIRA**

(vijon nga nr. 1 kaluar)																			
3529	Berat	3450	Arë	651,661.05	3585	Berat	5450	Arë	1,154,423.24	3642	Berat	3800	Arë	536,906.24	3699	Berat	3350	Arë	666,767.74
3530	Berat	3550	Arë	687,341.47	3586	Berat	8300	Arë	1,707,212.02	3643	Berat	4150	Arë	180,400.13	3700	Berat	2150	Arë	418,446.04
3531	Berat	24700	Arë	5,035,808.00	3587	Berat	2000	Arë	437,410.90	3644	Berat	3150	Arë	734,851.68	3701	Berat	3050	Arë	596,716.74
3532	Berat	22950	Arë	4,728,398.16	3588	Berat	2350	Arë	463,457.27	3645	Berat	2350	Arë	459,384.78	3702	Berat	2420	Arë	479,542.33
3533	Berat	7550	Arë	1,579,988.03	3589	Berat	11000	Arë	2,250,223.44	3646	Berat	17500	Arë	1,395,728.72	3703	Berat	3000	Arë	563,249.56
3534	Berat	5550	Arë	1,126,527.71	3590	Berat	3000	Arë	432,477.47	3647	Berat	14750	Arë	2,789,538.54	3704	Berat	2200	Arë	429,256.03
3535	Berat	18050	Arë	3,738,551.03	3591	Berat	2000	Arë	392,522.00	3648	Berat	4000	Pemto	3,541,560.99	3705	Berat	5325	Arë	1,111,620.04
3536	Berat	17100	Arë	3,428,112.30	3592	Berat	3750	Arë	741,385.13	3649	Berat	3700	Pemto	1,969,514.23	3706	Berat	4450	Arë+Truall	-
3537	Berat	3000	Arë	709,660.43	3593	Berat	40850	Arë	7,548,689.69	3650	Berat	2000	Pemto	246,485.48	3707	Berat	3400	Arë	676,897.89
3538	Berat	3000	Arë	610,655.97	3594	Berat	20300	Arë	4,027,570.16	3651	Berat	5000	Pemto	305,981.07	3708	Berat	3030	Arë	625,302.14
3539	Berat	8700	Arë	1,760,237.50	3595	Berat	6700	Arë	616,445.76	3652	Berat	3000	Pemto	303,078.97	3709	Berat	4850	Arë+Truall	-
3540	Berat	2650	Arë	517,160.40	3596	Berat	4500	Arë	856,244.23	3653	Berat	2200	Pemto	427,188.90	3710	Berat	5650	Arë	1,122,224.93
3541	Berat	11550	Arë	2,313,249.86	3597	Berat	3300	Arë	643,943.66	3654	Berat	3300	Pemto	660,245.56	3711	Berat	7500	Arë	1,554,153.06
3542	Berat	15100	Arë	3,201,546.20	3598	Berat	9650	Arë	1,952,628.80	3655	Berat	3000	Pemto	421,729.98	3712	Berat	25000	Arë	5,073,994.36
3543	Berat	7650	Arë	1,572,768.51	3599	Berat	3100	Arë	655,915.00	3656	Berat	2000	Pemto	403,763.89	3713	Berat	2000	Arë	410,589.56
3544	Berat	5600	Arë	809,079.28	3600	Berat	70000	Ullishte	13,953,769.69	3657	Berat	2200	Pemto	132,277.53	3714	Berat	4700	Arë	939,434.71
3545	Berat	11700	Arë	695,241.97	3601	Berat	4350	Ullishte	899,898.46	3658	Berat	2600	Pemto	403,924.46	3715	Berat	2550	Arë	544,990.62
3546	Berat	4450	Arë	933,221.97	3602	Berat	22700	Ullishte	4,581,093.28	3659	Berat	2000	Pemto	249,459.01	3716	Berat	11450	Arë	2,306,860.17
3547	Berat	3200	Arë	668,770.42	3603	Berat	25150	Ullishte	4,977,685.79	3660	Berat	2050	Pemto	568,769.96	3717	Berat	3100	Arë	591,486.29
3548	Berat	3000	Arë	507,941.50	3604	Berat	59550	Ullishte	9,696,841.21	3661	Berat	4000	Arë	824,181.49	3718	Berat	51000	Arë	10,192,299.63
3549	Berat	2500	Arë	524,650.37	3605	Berat	24000	Arë	4,861,088.68	3662	Berat	2500	Arë	469,977.38	3719	Berat	31000	Arë	6,273,188.82
3550	Berat	2900	Arë	598,675.90	3606	Berat	8200	Arë	1,711,697.74	3663	Berat	2400	Arë	164,046.51	3720	Berat	9900	A	1,917,387.29
3551	Berat	6250	Arë	1,316,379.52	3607	Berat	8000	Arë	1,716,208.87	3664	Berat	4450	Arë	884,781.35	3721	Berat	7850	Vreshtë	1,566,630.45
3552	Berat	2500	Arë	491,245.82	3608	Berat	4100	Arë	699,256.35	3665	Berat	3350	Arë	679,043.01	3722	Berat	106900	Vreshtë	21,719,267.44
3553	Berat	5750	Arë	178,640.14	3609	Berat	4900	Arë	1,047,267.80	3666	Berat	4080	Arë	827,461.23	3723	Berat	160900	Vreshtë	32,605,403.33
3554	Berat	11650	Arë	315,112.20	3610	Berat	2050	Arë	261,444.99	3667	Berat	3200	Arë	658,008.00	3724	Berat	87500	Vreshtë	17,838,192.02
3555	Berat	2000	Arë	397,489.23	3611	Berat	4900	Arë	953,223.81	3668	Berat	6150	Arë	1,247,018.10	3725	Berat	163000	Vreshtë	32,412,061.69
3556	Berat	22700	Arë	4,510,194.30	3612	Berat	2400	Arë	368,944.07	3669	Berat	4400	Arë	909,136.62	3726	Berat	2330	Ullishte	4,722,648.29
3557	Berat	14900	Arë	3,040,446.79	3613	Berat	2800	Arë	384,194.03	3670	Berat	2700	Arë	527,059.45	3727	Berat	10500	Ullishte	2,056,234.70
3558	Berat	6600	Arë	1,343,683.41	3614	Berat	5300	Arë	820,908.15	3671	Berat	2650	Arë	543,525.66	3728	Berat	24800	Vreshtë	5,173,345.80
3559	Berat	9300	Arë	1,875,347.26	3615	Berat	2000	Ullishte	350,225.41	3672	Berat	2900	Arë	587,790.60	3729	Berat	20400	Ullishte	4,052,505.62
3560	Berat	5250	Arë	1,059,247.69	3616	Berat	2850	Arë	589,568.78	3673	Berat	2350	Arë	467,541.27	3730	Berat	3800	Arë	705,461.32
3561	Berat	8400	Arë	1,698,245.01	3617	Berat	3400	Arë	422,006.97	3674	Berat	4650	Arë	1,150,259.38	3731	Berat	30200	Arë	6,114,690.80
3562	Berat	1650	Arë	326,199.16	3618	Berat	2000	Arë	446,421.92	3675	Berat	3650	Arë	774,892.66	3732	Berat	8100	Arë	1,720,944.69
3563	Berat	21800	Arë	4,447,500.64	3619	Berat	4300	Arë	871,099.62	3676	Berat	19750	Arë	4,021,791.58	3733	Berat	12200	Arë	2,501,878.69
3564	Berat	57950	Arë	11,773,133.26	3620	Berat	2100	Arë	433,916.16	3677	Berat	13350	Arë	2,760,017.89	3734	Berat	3750	Arë	744,768.43
3565	Berat	3840	Arë	7,691,488.00	3621	Berat	2450	Arë	477,102.55	3678	Berat	4450	Arë	931,450.16	3735	Berat	2500	Arë	544,721.82
3566	Berat	2350	Arë	449,419.74	3622	Berat	3700	Arë	749,976.32	3679	Berat	2300	Arë	453,585.72	3736	Berat	7100	Truall	-
3567	Berat	5200	Arë	1,035,293.54	3623	Berat	3800	Arë	765,480.97	3680	Berat	1000	Arë	196,108.09	3737	Berat	3000	Arë	636,186.59
3568	Berat	56700	Arë	11,489,598.44	3624	Berat	4400	Arë	884,963.45	3681	Berat	2350	Arë	481,475.38	3738	Berat	13900	Arë	2,854,485.58
3569	Berat	15650	Arë	2,242,508.65	3625	Berat	11400	Arë	2,312,854.41	3682	Berat	3375	Arë	702,995.10	3739	Berat	3900	Arë	847,531.21
3570	Berat	13700	Arë	2,476,830.92	3626	Berat	8700	Arë	1,657,877.27	3683	Berat	2800	Arë	583,126.58	3740	Berat	6500	Arë	1,330,341.17
3571	Berat	3000	Arë+Truall	-	3627	Berat	4400	Arë	902,320.11	3684	Berat	2300	Arë	471,503.19	3741	Berat	6500	Arë	1,293,098.53
3572	Berat	15850	Arë	3,254,300.70	3628	Berat	5000	Arë	1,387,075.32	3685	Berat	18502	Arë	367,769.30	3742	Berat	58500	Arë	1,185,641.43
3573	Berat	4250	Arë	827,271.87	3629	Berat	3400	Arë	724,347.38	3686	Berat	2000	Arë	420,575.82	3743	Berat	3200	Arë	632,625.36
3574	Berat	6900	Arë	1,386,200.71	3630	Berat	3750	Arë	1,307,438.51	3687	Berat	4300	Arë	903,911.04	3744	Berat	1850	Arë	358,403.81
3575	Berat	4400	Arë	882,072.01	3631	Berat	4650	Arë	923,147.76	3688	Berat	2700	Arë	555,870.79	3745	Berat	7300	Arë	1,478,234.23
3576	Berat	153500	Pemto	30,841,486.00	3632	Berat	4300	Arë	852,744.84	3689	Berat	2000	Arë	429,516.00	3746	Berat	13550	Arë	2,774,091.16
3577	Berat	59750	Pemto	11,570,068.96	3633	Berat	2350	Arë	475,142.44	3690	Berat	3100	Arë	623,570.82	3747	Berat	3450	Arë	702,441.03
3578	Berat	69100	Pemto	14,023,528.33	3634	Berat	4850	Arë	1,009,701.29	3691	Berat	4065	Arë	809,401.71	3748	Berat	14800	Arë	2,867,475.30
3579	Berat	46500	Arë	9,427,056.70	3635	Berat	2000	Arë	411,851.17	3692	Berat	3425	Arë	712,092.32	3749	Berat	2200	Arë	449,371.79
3580	Berat	200850	Pemto	40,741,510.33	3636	Berat	7050	Arë	1,443,609.37	3693	Berat	7850	Arë	1,585,458.81	3750	Berat	8850	Arë	1,783,544.90
3581	Berat	7650	Pemto	1,101,480.76	3637	Berat	11500	Arë	2,295,769.28	3694	Berat	44550	Arë	8,933,296.69	3751	Berat	10100	Ullishte	2,048,753.25
3582	Berat	3500	Pemto	727,702.92	3638	Berat	40500	Pemto	7,565,954.07	3695	Berat	2350	Arë	471,465.04	3752	Berat	9000	Arë	1,658,642.01
3583	Berat	942																	

Opinion i Ditës

Nga Miron Çako \*

# Vlera e jetës!

**J**eta, si fjalë dhe koncept filozofik, është e vështirë për t'u përcaktuar në të gjitha dimensionet e saj. Por, si përkufi zim biologjik, mund të themi se është një veti themelore e genieve të gjalla, pavarësisht nga veçoritë e gjinisë dhe llojit të tyre që lindin, zhvillohen dhe vdesin.

Për njeriun, i cili ka një jetë jo vetëm biologjike përtej instinkteve shtazore, jeta është më tepër se ekzistencë riprodhimi; ajo është një mundësi brenda kohës dhe hapësirës, që ai të zhvillohet dhe të përsoset si qenie intelektuale dhe morale. Prandaj, ndryshe nga kafshët, që kanë vetëm një frymë jete, njerëzit që kanë një shpirt të gjallë e të arsyeshem bëjnë pyetje të tilla rreth jetës: "Cila është origjina e jetës? Për çfarë arsyeje jetojmë? Cila është domethënia dhe rëndësia e saj?".

Për çdo qenie biologjike dhe veçanërisht për njeriun, jeta fillon në çastin e konceptimit në fekundimin e vezores nga spermatozoidi. Molekula që formojnë ADN-në e babait dhe të nënës kombinohen duke krijuar një jetë të re, e cila fillon me të gjithë potencialin e saj, pavarësisht nga përmasa mikroskopike të qelizës fillestare, e cila ndahet në qeliza të tjera deri në përfundim të strukturës embrionale të trupit dhe në vazhdimin deri në fund të jetës biologjike.

Çështja se kur fillon jeta nuk është më një çështje e teologjisë apo filozofisë; ajo lehtë mund të përgjigjet nga biologjia elementare. Për më shumë se 100 vjet, shkencën mjekësore ka njohur përfundimisht se jeta e çdo individ fillon në momentin e fekundimit. "Një individ i ri krijohet kur elementët e një spermie të fuqishëm bashkohen me ato të një veze pjellore ose vezësh" (Enciclopedia Britanike)

"Është depërtimi i vezës nga një spermatozoid dhe sjellja e materialit ADN-së, që sjell secila në këtë bashkim. Kjo përbën kulminacionin e procesit të fekundimit, që shënon fillimin e jetës së një individi të ri". Bradley M. Patte (1889-1971) "Embryology History" (Parimet e Embriologjisë 1964)

Pra, mund të themi se filozofët dhe teologët kanë argumentuar për shprehje se kur fillon personaliteti, por shkencëtarët e dinë kur fillon, ajo fillon me fekundimin.

Kjo e vërtetë shkencore është shprehur me mijëra vjet përpara në Biblën e shenjtë, ku mbreti dhe profeti David (1005-965 para Kr.), i frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë, tha: "Sytë e tu panë masën pa trajtë të trupit tim dhe në lirin të ishin shkruar ditët që ishin caktuar për mua, megjithëse asnjë prej këtyre nuk ekzistonte ende" (Psalmi 139:16).

Për origjinën e jetës ka shumë hipoteza, ajo më e vjetra është se jeta njerëzore është krijuar nga një qenie hyjnore që ekziston nga vetvetja. Kjo teori ishte përcaktues deri në shek. e 19-të dhe frymëzoi shkencën, artin, kulturën, qytetërimin, por në këtë shekull doli një teori tjetër hipotetike se jeta në tokë u krijua si një kombinim aksidental kimikatesh të qajtura edhe "supë-prebioitike", ku molekula u kombinuan dhe krijuan njëqelizorët (bimë), vetë jetën, e kështu në vazhdim shumëqelizorët, në të gjithë evolucionin që vazhdoi deri te njeriu kjo e qajtur "Teoria e evolucionit" me autor Charles Robert Darwin (1809-1882), Një tjetër hipotezë e shekullit të 20-të është ajo se jeta është krijuar nga jashtëtokësorët.


Arsyetimi logjik sado të sforcohet nuk mund ta mohojë dot ekzistencën e një Krijuesi që ekziston nga vetvetja dhe krijon jetë dhe nuk e pranon "Teorinë e Evolucionit", sepse që jeta të jetë aksidentale me të gjithë kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e saj është një probabilitet i pamundur, po ashtu edhe teoria e jashtëtokësorëve sikur ata të jenë shkaku i jetës. Sepse, që të ekzistojë diçka me jetë në këtë univers, duhet të ketë një shkak fillestar ashtu si dhe vetë universi, po ashtu edhe jashtëtokësorët në goftë se ekzistojnë vërtet.

Kështu mbetet më i arsyeshem pohimi i shkencës së teologjisë se jeta e çdo qenieje dhe veçanërisht e njeriut ka një shkak primar, një Arkitekt, i cili na solli nga mosqenia në qenie. Kjo Qenie Hyjnore vetëkrijuese dhe shkak i jetës së çdo qenieje dhe veçanërisht të njeriut, është prezantuar me emrin: "Unë jam Ai që jam" (Eksodi: 3-14), pra ekzistoj nga vetvetja dhe jam "Zoti i përjetshëm".

Asnjëherë në mënyrë të pavarur nga Perëndia nuk ka as jetë, as lëvizje si thotë edhe psalmi: "Kur ti e fshehe fytyrën, ato tronditen; kur ua merr frymën, ato vdesin dhe kthehen në pluhur përsëri" (Psalmi 10:9). Çdo frymë jete vjen për të gjitha gjallesat nga Zoti, por fryma e njeriut vjen në një mënyrë më të veçantë nga Ai, si na thuhet: "Atëherë, Zoti Perëndi formoi njeriun nga pluhuri i tokës, i fryu në vrimat e hundës një frymë jete dhe njeriu i bë të një shpirt i gjallë" (Zanafilla 2:7). Kështu, jeta njerëzore nuk është rastësi, por është dhuratë që duhet jetuar me përgjegjshmëri, ajo është e shenjtë. Vetë ligjet Hyjnore mbrojnë jetën njerëzore dhe ndalojnë vrasjen, vetëvrasjen dhe çdo abuzim me të, sepse jeta nuk është vetëm e njeriut.

Por, fatkeqësisht, shikojmë sidomos në këtë brez egoist dhe të papërdëshëm se jeta po e humbet vlerën e saj, sa njerëzit jo vetëm që vrasin të tjerët dhe nuk i bren ndërgjegjia, por ata në dëshpërim total vrasin edhe veten duke e qajtur jetën një fatkeqësi, apo një mallkim, ashtu siç shprehen dhe frymëzimet filozofike e dëshpërimit: "Jeta është një sëmundje që përhapet përmes marrëdhënieve seksuale" (R.D. Laing). "Jeta është vetëm një gjë e mallkuar pas një gjëje tjetër"

(Elbert Hubbard (1856-1915)). "Jeta nuk është e drejtë. Thjeshtë është vetëm më e drejtë se vdekja" (William Goldman). "Jeta është një seri e pazgjidhshme situatash të rreme". (Thornton Wilder (1897 - 1975).



Statistikat sipas OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) janë të frikshme: Një person kryen vetëvrasje për çdo 40 sekonda, një person vritet çdo 60 sekonda dhe një person vdes në konflikt të armatosur çdo 100 sekonda.

Kjo ndodh sepse njerëzit e përcmojnë jetën dhe nuk e pranojnë që është dhuratë nga Zoti, që ata duhet ta jetojnë dhe ta mbrojnë të tyren dhe respektojnë të tjerit, ashtu siç thotë edhe Johan Volfgang Gëte (1749-1832): "Njerëzit përcmojnë atë që nuk kuptojnë".

Jeta e krijuar në vetvete është e brishtë. Jeta e çdo qenieje është e pasigurt dhe rrezikon t'i nënshtrohet vdekjes çdo ditë. Kjo gjë vërteton se asnjë qenie nuk erdhi në ekzistencë nga vetvetja, po ashtu edhe njeriu nuk është autonom dhe nuk e ka jetën nga vetja, por siç thamë më sipër, jeta është dhuratë e Perëndisë, të cilën ashtu si ta jep, po ashtu ka dhe të drejtë që të ta marrë.

Jeta është vërtet e shkurtër, ngrihet si avull nga toka dhe vitet e saj nuk shkojnë më shumë se 70-80 vjet, si e thotë psalmisti: "Ditët e viteve tona shkojnë deri në 70 dhe për më të fortët deri në 80...", sepse jeta kalon me shpejtësi dhe ne fluturojmë tutje" (Psalmi 90:10).

Sipas statistikave (Birth dhe Death Rates Ecology Global Network), numri i vdekjeve është: -15.872 vdekje për 100.000 banorë; 6.316 vdesin çdo orë; 55.3 milionë njerëz vdesin çdo vit.

Kështu, duhet të jemi seriozë me jetën dhe duhet ta vlerësojmë dhe të përfitojmë prej saj në çdo stad, ashtu si edhe nënë Tereza, një mbrojtëse e flaktë e jetës në të mënyrë poetike "Himnin e jetës":

Jeta është një shans, kajo.  
Jeta është bukuria, adhurjoje.  
Jeta është bekimi, shijoje.  
Jeta është ëndërr; bëje realitet.  
Jeta është sfidë, përballjoje.  
Jeta është detyrë, kryeje.  
Jeta është lojë, luaje.  
Jeta është e çmuar, kujdesu për të.  
Jeta është pasuri, vlerësoje.  
Jeta është dashuri, jetoje.  
Jeta është mister; zbuloje.  
Jeta është premtim, mbaje.  
Jeta është trishtim, kaloje.  
Jeta është himn, këndoje.  
Jeta është luftë, pranoje.  
Jeta është aventurë, rrezikoj.  
Jeta është jetë, mbroje.

Vlera e jetës duket kur ajo përfundon në tatëpjetën e moshës së pleqërisë apo në frymëmarritjen e saj të fundit. Sa njerëz pendohen kur iu perëndon "dielli" i tyre për jetën që e çuan dem, por koha mbaron dhe jeta është si uji që rrjedh dhe nuk kthehet pas, ajo na jepet vetëm një herë për ta jetuar, kur e humbasim e vlerësojmë, por është shumë vonë.

Por, duket një paradoks i madh që një njeri lind dhe jeton për të vdekur. Kjo është e panatyrshme, sepse në goftë se do të ishte natyrale vdekja, njeriu nuk do të kishte frikë prej saj dhe nuk do ta kundërshtonte. Ai do ta pranonte ashtu siç pranon dhe kryen aktivitetet e tjera natyrale jetike si ushqimi, frymëmarrja etj.

Thamë më sipër që jetën e krijoj Zoti i përjetshëm, por përsëri është paradoks i madh se sesi Zoti i jetës të mund të krijonte vdekjen, e cila asgjëson jetën, këtë gjë nuk do ta bënte asnjë

mjeshtër i zakonshëm njerëzor dmth., të krijonte për t'i shkatërruar më pas veprat e tij, aq më tepër Mjeshtri Hyjnor të krijonte jetë që më pas ajo të shkatërrohej nga vdekja, si e krijuar prej tij.

Por, Perëndia nuk e krijoj vdekjen dhe nuk gëzohet me vdekjen e qenieve. Ai nuk e krijon njeriun që të vdesë, por që të jetojë. Vdekja që na duket si një borxh "natyral" është pasojë e mosbindjes së njeriut në kopshtin e Edenit, i cili nuk iu bind porosisë së Perëndisë: "Mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, sepse ditën që do të hash prej saj, ke për të vdekur me siguri" (Zanafilla 1:17).

Mëkati i mosbindjes është shkak i vdekjes dhe çdo mëkat personal e shpejton vdekjen, sepse vdekja e ka pushtetin tek mëkati dhe mbas tij qëndron djalli dhe demonët.

Njerëzit që janë shkelës të ligjit, që bëjnë keq, abuzojnë, shpejtin rregullat, që nuk bëjnë kujdes, rrezikohen nga vdekja e theyjetë, e cila i përgjon si hajduti dhe vjedh jetën e çdokujt që nuk e respekton atë. Ja seç thuhet te fjalët e urta të Solomoni: "Ashtu si drejtësia të çon në jetë, kështu ai që shkon pas së keqes gjen vdekjen" (11:19).

Por, duhet të sqarojmë edhe një të vërtetë themelore për sa u përket proceseve të jetës.

Jeta njerëzore që lind me konceptimin, fertilizimin kalon në tri stade:

1. Stadin embrional, brenda mikrobotës në placentën e mitrës së nënës.

2. Stadin e përkohshëm, brenda kohës dhe hapësirës në tokë.

3. Stadin e përjetshëm, përtej kohës dhe hapësirës. Njeriu, si qenie shpirt-trup (psiko-somatike), kur vdes fizikisht, nuk pushon së ekzistuar si kafshët, sepse shpirti i tij është shpirt i gjallë jomaterial, që jeton edhe mbas vdekjes. Kjo është besuar nga njerëzit që në zanafillën e tyre dhe është shprehur me nderimin e të vdekurve, me të cilët të gjallët nuk e humbasin komunikimin, i nderojnë, i kujtojnë, madje dhe iu luten atyre. Kanë eksperiencat e ëndrrave, vegimet të cilat na japin mesazhe për botën e të vdekurve. Edhe dëshira e njeriut për të mos pranuar vdekjen duke e konsideruar atë si armik, duke u përpjekur për ta mundur vdekjen me aspiratën e pavdekësisë, janë tregues se pavdekësia nuk është iluzion, por një realitet i humbur që njeriu kërkon ta rifitojë.

Por, askush nga njerëzit nuk e ka mundur vdekjen që të rifitojë pavdekësinë, sepse të gjithë njerëzit lindin me farën e mëkatisë të Adamit edhe vdekja skllavëron që embrion. Ashtu si na thuhet në Dhiatën e Re: "Të gjithë vdesin në Adamin" (Korintasve 15:22).

I vetmi njeri që e mundi vdekjen me vdekjen e tij duke u ngjallur nga të vdekurit, është Jisu Krishti, i Cili si Bir i Perëndisë, është i pavdekshëm dhe vdekja nuk mund ta presë, por edhe si Njeri i lind pa mëkatin e Adamit, sepse lindi nga "fara e gruas", nga një virgjëreshë dhe nuk bëri mëkat personal në jetën e tij tokësore. Kështu vdekja, që e ka fuqinë të mëkatisë, nuk kishte pushtet mbi Krishtin, ashtu si vetë Ai tha: "Prandaj Ati më do, sepse unë e bë jetë time që ta marr përsëri... Unë kam pushtet ta lë dhe ta rimarr përsëri, ky është urdhri që kam marr nga Ati im" (Joani 10:18). Krishti si Princi i jetës tha: "Unë jam i pari dhe i fundit, dhe i gjalli; isha i vdekur, por ja, jam i gjallë në jetë të jetëve, Amin dhe Unë i kam çelësat e vdekjes e të Hadhit" (Zbulesa 1:18).

Ngjallja e Krishti është ngjallja jonë dhe fitorja e njerëzimit mbi vdekjen, kështu çdo njeri u rrijepet mundësia për të jetuar përgjithmonë si i pavdekshëm, ai i bashkuar me Krishtin mund të thërrasë "Vdekja u përpi në fitore! O vdekje, ku është gjëmba jote? O ferr, ku është fitorja jote?" (1 Kor 15: 55-57).

Krishti i fton njerëzit e vdekshëm në përjetësi: "Kush beson te Biri (Jisu Krishti), ka jetë të përjetshme; kurse kush nuk i bindet Birit, nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të" (Joani 3:36).

Të gjitha fetë dhe veçanërisht Krishterimi presin ditën e fundit të botës, e cila do të paraprhet nga ringjallja e të vdekurve dhe vdekja nuk do të ekzistojë më, sepse: "Ashtu siç erdhi vdekja me anë të një njeriu, kështu erdhi dhe ringjallja e të vdekurve me anë të një njeriu. Sepse, ashtu sikurse të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin, por secili sipas radhës së vet: Krishti, fryti i parë, pastaj ata që janë të Krishtit, në ardhjen e tij. Pastaj do të vijë fundi, kur ai do t'ia dorëzojë mbretërinë Perëndisë Atë, pasi të ketë asgjësuar çfarëdo sundimi, pushteti e fuqie. Sepse duhet që ai të mbretërojë, derisa t'i vërë të gjithë armiqtë e tij nën këmbët e veta. Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja" (1 Korintasve 15:21-26).

Kështu, njerëzit do të hyjnë në dimensionin e përjetshëm jo vetëm me shpirt, por edhe me trup dhe do vendosen në gjendje të ndryshme jete në parajsë apo në ferrë, sipas gjyqimit të drejtë të Krishtit, i Cili thotë: "U bë! Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi! Atij që ka etje, unë do t'i jap si dhuratë nga burimi i ujit të jetës... Kurse për frikacakët dhe të pabesët, dhe të neveritshmit, dhe vrasësit, dhe kurvëruarit, dhe magjistartë, dhe idhujtarët, dhe gjithë gënjeshtarët, pjesa e tyre do të jetë në liqenin që digjet me zjarr dhe sqfurr, që është vdekja e dytë" (Zbulesa 21:6-8).

Duke parë këtë perspektivë eskatologjike të jetës, shikojmë se jeta ka një vlerë të pallogaritshme dhe ajo jo vetëm që duhet jetuar, por duhet vlerësuar me përgjegjshmëri në çdo frymëmarje të saj, sepse mënyra sesi jetohet jeta e përkohshme përcakton jetën e përjetshme ashtu si na përmbledh Shën Grigor Theologu (329-390): "Jeta e tanishme hap perspektivën e jetës së përjetshme. Jeta e tanishme e njeriut drejtohet në jetën e vërtetë, në jetën e veçantë, në jetën e Perëndisë: "Një jetë shih drejt jetës tjetër".

\* Përgjegjës i Zyrës së Katekizimit në Kryepiskopatin e KOASH, Tiranë

Opinion i Ditës

Nga Julian Zyla

# Çfarë mund të humbasë LSI nga aleanca me PD

(Vijon nga faja e parë)

... kretësisht fytyrën e kryetarës së LSI-së, Monika Kryemadhi. Kjo rastësi (tele)vizive mund të konsiderohet ironike për faktin që znj. Kryemadhi me siguri zgjodhi vetë të ishte aty. LSI ishte pranë PD-së në opozitë, së bashku me kryetarët e partive të tjera. Tashmë, këto ish-in kushtet. A është ky një kënd i favorshëm?

Natyrisht, znj. Kryemadhi mori edhe fjalën gjatë asaj deklarate e më pas z. Basha u lehtësua kur vëmendja e mikrofonat u rikthyen tek ai. Por, a i intereson LSI-së kjo aleancë me PD-në e kësaj periudhe? A është brand-i PD në momente pozitive, që do të justifikonte bashkimin me të? Çfarë mund të jetë duke humbur LSI nga kjo aleancë?

Së pari, le ta nisim nga një konstatim i thjeshtë, që tregon ndryshimin në strategji midis LSI-së dhe aleatëve të tjerë të PD-së. Partitë aleate të Partisë Demokratike konkurruan në zgjedhjet me kryetarët e tyre brenda listave të PD-së, të detyruar nga kodi zgjedhor i hartuar nga dy partitë e mëdha. Pas zgjedhjeve, ata u rikthyen në kryetarë partish. Lëvizja Socialiste për Integrim bëri disa të kundërtën. Kaloi zgjedhjet jo vetëm jashtë, por edhe kundër dy partive të mëdha dhe pasi kaloi sproven, iu bashkua PD-së pas zgjedhjeve. Bashës iu konfirmua lidhshipi nga ky rreshtim i LSI-së në skuadrën e tij. Po Kryemadhi çfarë fitoi nga ky pozicion i ri? A i duhej një skuadër?

Së dyti, LSI është tashmë një parti brenda koalicionit opozitar. A nuk do të ishte më mirë të ishte një pol ndryshe? Lëvizja Socialiste për Integrim shprehet shpesh kundër regjimit qeveritar. A nuk do të ishte më mirë nëse shprehej kundër regjimit të dy partive të mëdha, që kanë udhëhequr këto 27 vjet?

Pra, LSI mund të jetë duke hequr dorë nga mundësia për t'u konfirmuar jo si një parti opozitare, por si një pol opozitar. Opozita e bashkuar dhe e koordinuar mund të jetë më e zëshme kundër qeverisë. Protestat më impresionuese. Por frytet e punës së partive të veçanta brenda koalicionit do të jenë të vështira për t'u korrur. Monika Kryemadhi nuk do t'i duhet të garojë në listën e PD-së, por mund të jetë e vështirë të brandohet LSI si forca autonome që ka qenë deri tani.

Së treti, përveç aspektit të strukturës/formës, bashkimi me PD-në rrezikon ta devijojë LSI-në edhe në përmbajtje, nga një parti që synon të shprehet me përpërsi për problemet e drejtpërdrejta të njerëzve, "punësimi, punësimi, punësimi", në një operator politik të brendshëm, të angazhuar me probleme politikanësh.

Njerëzit frymëzohen vetëm nëse qëndron me ta. Nuk mjafton vetëm gjatë fushatës. Aq më tepër kur fushatat tashmë nuk mbarojnë realisht pas zgjedhjeve (koncepti i fushatave të vazhdueshme), njerëzit duan të qëndrohet me ta, pra me problemet e tyre, në çdo



moment. A po vazhdon z. Basha të flasë për ekonominë? Sipas kujt studimi hashashi është më i rëndësishëm e më shqetësues sesa ekonomia për shqiptarët?

Lëvizja Socialiste për Integrim ka mundësi të mbushë hapësirën e pashfrytëzuar në opozitë me përmbajtje më të rëndësishme për njerëzit sesa "Poshtë Edi Rama". Sepse, për të frymëzuar, gjithashu, nuk mjafton të thuash se për çfarë je kundër, por mbi të gjitha, duhet të shprehësh për çfarë je pro.

Së katërti, duke mos përjashtuar mundësinë se LSI mund të ketë nevojë për një aleancë me PD-në, meqenëse vetëm të dyja mund të përballen numerikisht me PS-në, a ishte e dobishme që aleanca të ndërtohej pikërisht tani? Pra, a është e bindur LSI që ky ishte pozicioni maksimal i forcës me të cilën mund të paraqitej për bashkëpunim me PD?

Nëse analizohen prirjet elektroale të dy partive mund të mendohet e kundërta. Të qenit në opozitë nuk i mjaftoi PD-së të

frymëzonte masat, duke shkuar drejt rënies numerike. Lëvizja Socialiste për Integrim ka arritur të shtojë deri tani radhët e saj. A është mënyra më e mirë e të bërit opozitë në koalicion, aq më tepër kur nuk duhet arritur një shumicë për t'u folur të pakënaqurve?

Deri tani Kryemadhi ka kryer veprime opozitare shumë mediatike dhe u drejtohet grave shqiptare si gruaja e vetme kryetare e një partie të madhe në Shqipëri. Ndërkohë, PD vazhdon me kanabizimin si kryefjalë dhe me protestat si shprehje e vetme politike. Pra, edhe nëse shihen veprimet në opozitë PD, nuk duket të udhëheqë politikisht. Atëherë, a është i nevojshëm ky pozicionim ndaj një force historike?

Së fundmi, bashkimi midis LSI-së dhe PD-së ndodhi kaq gradualisht, saqë mospublicizimi i tij si ngjarje politike në vetvete mund të ketë qenë një mundësi e humbur për palët. Me gjithë ekuilibrat e shumtë që duheshin marrë parasysh duke konsideruar historinë e

forcave politike në Shqipëri, çdo aleancë është një lajm në vetvete, i cili mund të rrëfëhet sipas versionit më të mirë të autorëve. Në vend që kjo aleancë të shfaqej si një dukuri thaujse natyrore mes kundërshtarëve të qeverisë, mund të ishte një aktivitet më vete, ku palët shprehnin fushat ku do të bashkëpunonin.

Aktiviteti mund të ishte i suksesshëm, siç u tha për protestën. Përfitimet për PD-në do të ishin të dukshme. Do të kishte përfutur edhe LSI më shumë sesa me gradualitetin e aleancës. Por ato që mund të humbasë prej saj nuk do të ndryshonin.

Natyrisht, LSI veçohet shpesh nga PD me veprimet e saj brenda dhe jashtë parlamentit, por këto mund të mos mjaftojnë ta paraqesin si skuadër më vete. Maksimumi si një lojtar të dalluar brenda skuadrës së re. Lojtarit të dalluar do t'i shfaqet emri dhe do t'i vijë mikrofonat për intervista para dhe pas ndeshjeve. Por loja po luhet mes PS dhe PD.

## HOROSKOPI

### DASHI

Ndjenjat ju shpërthen në mënyrë eksplozive, që është tipike e shenjes suaj, por edhe nga llastimet dhe ekzagjerimet e tepërta që rrezikojnë t'ju largojnë personat që keni afër. Të tjerët, më të rezervuar se ju, ju gjykojnë me sy kritik si persona gjaknxehtë, që nuk mund të mbani veten nën kontroll.

### DEMI

E doni punën tuaj dhe e bëni me pasion, përtej aspektit fitimprurës. Ju karakterizon një atmosferë bashkëpunuese. Me kolegët dhe bashkëpunëtorët krijoni miqësi, duke kërkuar raste për t'u takuar edhe jashtë zyrës.

### BINJAKET

Udhëtimet, studimet dhe çdo gjë shkon shumë mirë, përfshirë dashurinë. Pavarësisht rraheve të zemrës dhe romancës, mendja është mjaftueshëm e kthjellët për të dhënë më të mirën. Humori i mirë largon çdo shqetësim. Mbrëmje ideale për të dalë në grup ose vetëm me partnerin tuaj.

### GAFORJA

Komplikimet dhe ndryshimet e programit ju nervozojnë. Kur nisni një projekt, bëni të pamundurën për ta përfunduar. Partner kokëfortë, por tani që keni zbuluar çelësin e duhur të zemrës së tij, e dini si duhet të veproni.

### LUANI

Komunikimi i sotëm mes frazave romantike dhe propozimeve do jetë një gërshetim temash interesante. Të privilegjua të gjitha udhëtimet, që nga ato e shkurtra disa kilometra deri tek fluturimet e gjata.

### VRIGJERESHA

Negociata të rëndësishme biznesi ju presin sot. Ndoshta keni nënshkruar ndërmjetësin, që tani ju duket një profesionist i vërtetë. Fitime të vogla, megjithëse shpresonit diçka më tepër. Më mirë qartësoni idetë para se të përballeni me një kolegun tuaj.

### PESHORJA

Do e filloni javën me këmbë të mbarë, me Hënë në shenjë, në harmoni me Diellin dhe Venusin. Çdo gjë e përkryer, dashuria, miqësia, krijimtaria... Vetëm familja ju merrit pak, nën ndikimin e Plutonit si gjithmonë.

### AKREPI

Bashkëbisedues i vështirë, nëse propozoni "a", dëshironi "b"; nëse kaloni tek "b", preferoni "a"! Vetëkontrolli dhe diplomacia janë kartat e duhura për t'u luajtur. Një çështje ligjore do shtyhet përsëri, mbani mend proverbin "qetësia është virtyt i të fortëve".

### SHIGJETARI

Jeni fatlumët e zodiakut, të përkëdhelur nga Hëna dhe Dielli në kënd. Të privilegjuar udhëtimet, duken mirë gjithashtu çështjet e biznesit, përfshirë edhe ato të zemrës. Bashkëpunimi me një person që e njihni mirë nuk ju rezervon surpriza dhe do jetë strategjia fituese.

### BRICJAPI

Në shënjestër nga Hëna dhe Urani do drejtoni të gjitha energjitë drejt realizimit shoqëror-profesional. Telashe në familje, ndoshta duhet të jepni një shumë të madhe për të ndërruar një pajisje elektro-shtëpiake që është prishur.

### UJORI

Dielli dhe Venusi në shenjë të lidhur me Hënë do të thotë një mrekulli për femijet e prindërve të shenjes së Dashit, që dashuronjë udhëtimet dhe surprizat. Nëse ka një mundësi për t'u transferuar ose të paktën një udhëtim jashtë shtetit, do jeni të lumtur të bëni valixhin gati.

### PESHQIT

E hënë e zakonshme, pa asnjë lëvdatë. Një fillim jave që mund të anulojë, madje do ishte zgjidhja gjeneale. Një miku juaj shpreson ta transformojë marrëdhënien tuaj në diçka më të afërt.



TË KUQTË TRIUMFOJNË 2-1



Partizani rikthehet te fitor ja pas dy dështimeve radhazi në Vlorë dhe këtë e bën në ditën e përvjetorit të tij të 72-të. Të kuqtë kanë triumfuar 2-1 ndaj Kamzës, që u lejon të mbajnë gjallë shpresat për Kupat e Europës, por mbi të gjitha i lejon të parakalojnë pikërisht kamzalinjtë në renditje. Dhe në "Selman Stërmasi", orteku i golave do të nisë shumë shpejt. Minuta e 6-të dhe portieri Gjonikaj vihet në vështrësi, pasi topi i krosuar

Partizani thyen Kamzën me golat e Asanit

nga Bardhi godet traversën dhe gjen Asanin, që nga fare pranë dhe me portën e boshatisur nuk e ka të vështirë të shënojë. Sërish ngjitet në "katedër" ish-lojtari i Vardarit në minutën e 23-të, kur shërbehet shkëlqyeshëm nga Lukas dhe thyen Gjonikën për të dytën herë. Duket se të kuqtë e fusin në

'kasafortë' trepikëshin, por Sebino Plaku i kthen me këmbë në tokë shumë shpejt, kur me kokë ngushton shifrat 2-1 pas harkimit të Idrizajt, një gol mjaft i bukur ky i ish-sulmuesit të të kuqve. Edhe në pjesën e dytë, Partizani e nis me shumë vrull sikurse në të parën. Në minutën e 49-të

Trashi i shkon fare pranë golit të tretë, kur lëshon një goditje fantastike nga një faull pranë zonës së Kamzës, por vetëm trau i portës e ndal. Në minutën e 57-të është Jurgen Bardhi, që lëshohet nga Progni drejt zonës kundërshtare dhe i vetëm përballë Gjonikajt gjuan në parabolë, por gjen vetëm shtyllën e jashtme, duke shpërdoruar një gol të sigurt. Në minutën e 70-të provon Batha nga goditja e dënimit, por topi devijohet në

këndore, ndërsa të kuqtë nisnin të tërhiqen në mbrojtje të rezultatit, duke u lënë terren miqve, që gjithsesi nuk arrijnë të godasin. Ndeshja mbyllet me momente nervozimi nga lojtarët e të dyja kampeve, ndërsa pas vërshëllimës së trefishtë të Andi Koçit, të kuqtë e shohin veten në kuotën e 27 pikëve, në mesin e artë të tabelës së renditjes, 5 pikë poshtë Flamurtarit të vendit të dytë.

Bardhekuqtë pësojnë të parët në Shkodër, por përmbysin Vllazninë me poker golash

# Kukësi ndal Flamurtarin, kënaqet Skënderbeu



Jeton Selimi

Ndërmjet Kukësit dhe Flamurtarit, ai që fiton është Skënderbeu. X-si në "Zeqir Ymeri" u shkon më shumë përshtat korçarëve, pasi ndalet vlonjatët duke thelluar diferencën në puls 8, ndërsa Kukësi qëndron në vend numëro. Trajneri Peter Paull dëshon të dhurojë tifozëve fitoren e parë brenda, ndërsa Shpëtim Duro ndalet sërish tek arbitrat duke akuzuar duke i cilësuar si kamikazë, të cilët i hoqën ekipit të tij të drejtën për të fituar. Sigurisht që kjo ishte një ndeshje delikate për të dyja ekipet. Vetë rëndësia e këtij takimi bëri që ritmi i lojës të mos ishte i lartë dhe i përqendruar më shumë në mesfushë. Rastet për shënim nuk erdhën si rrjedhë logjike, por falë disa

## Vlonjatët e kanë me Hamitin, u mohoi penallti

gabimeve si shtylla e Kukësit në minutën e 27-të, ku një mbrojtës i Flamurtarit për pak shënoi në portën e tij. Megjithatë, kur skuadrat po u drejtoheshin dhomave të zhveshjeve, Danilo Avlesh devijon me trup një top të ardhur nga goditja e këndit, duke kaluar Flamurtarin në avantazh. Ritmi i lojës ndryshoi në pjesën e dytë me Kukësin që kërkonte të ndryshonte rezultatit, faullet e shumtë dhe kartonët nuk i lejuan skuadrat të shpreheshin në fushë. 5 minuta përpara përfundimit të ndeshjes, gjyqtari i takimit, Hamiti akordon penallti për prekje të topit më dorë nga Pollozani. Nga pika



e bardhe e penalltisë Elis Bakaj u tregua i saktë duke sigeluar shifrat përfundimtare në 1-1. Skënderbeu udhëtonte

në "Loro Boriçi" me pikësynimin e vetëm, fitoren, e cila i mungon për këtë vit të ri kalendarik, ndërsa Vllaznia për të lënë pas humbjen me

Kukësin. Sikundër pritej, takimi nis i fortë dhe me rastet. Fillimisht do të jetë Xhejms që do të shpërdorojë në minutën e 2-të një rast të mirë në shënimi, ndërsa të parët që kalojnë në epërsi do të jenë të zotët e shtëpisë, kur në minutën e 6-të Sedat Berisha, mbrojtësi i afruar në këtë merkato janari, do të thyejë me kokë Orges Shehin. Vllaznia ka një mundësi të artë për ta çuar ndeshjen në 2-0 10 minuta më pas, por Çinari i vetëm përballë Shehit gabon në parabolën e tij, me gardianin që bën një ndërhyrje vendimtare. Në minutën e 25-të Skënderbeu i shkon edhe njëherë shumë pranë barazimit, por Sherrri bën një ndërhyrje vendimtare. Nuk ka ç'të bëjë 7 minuta më pas gardiani shkodran, kur Osmani harkon shkëlqyeshëm në zonë për kokën e

Vangjelit, që lë të shtangur portierin. Pjesa e parë mbyllet në barazim 1-1, por në të dytën kryesuesit e kampionatit do të shpërthejnë. Në minutën e 60-të Enea Jorgji e gjykon si prekje me dorë të topit planzhonin e Berishës dhe akordon një penallti, të cilën e kthen në gol Sabien Lilaj. Vllaznia shtyn para, por çuditërisht Ribaj e Sukaj nuk arrijnë të konkretizojnë, ndërsa në minutën e 75-të shfaqet Muzaka, që pasi lë në vend Malotën, shënon golin e tretë për Skënderbeun. Shkodranët janë të dorëzuar, por jo Xhejms, që 2 minuta nga fundi shënon dhe golin e katërt të takimit. Skënderbeu ngjitet në kuotën e 40 pikëve, ndërsa Vllaznia mbetet e parafundit me 15 pikë.

SUPERLIGA		
JAVA E 18		
TË DIELËN		
Laçi - Teuta		0-0
Vllaznia - Skënderbeu		1-4
Lushnja - Luftëtari		0-0
Kukësi - Flamurtari		1-1
Partizani - Kamza		2-1
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Skënderbeu	18	40
Flamurtari	18	32
Kukësi	18	29
Laçi	18	28
Partizani	18	27
Kamza	18	26
Luftëtari	18	23
Teuta	18	17
Vllaznia	18	15
Lushnja	18	10

Akuzat e trajnerit të Flamurtarit

Duro: Arbitra kamikazë, nuk u besohej kur shënuam

Trajneri i vlonjatëve, Shpëtim Duro, nuk është i kënaqur me pikën e marrë në Kukës, pasi është ndëshkuar sërish nga gjykimi, nga dy "kamikazët", siç i quan ai, Hamiti dhe Myrtja. Trajneri i Flamurtarit ka parasysh një penallti të padhënë për skuadrën e tij. "Një pikë mund të jetë shumë e rëndësishme në fushën e Kukësit, por ashtu si u zhvilluan situatat e lojës, jam shumë i mërzitur. Nuk ishte një barazim i merituar i Kukësit. Na ka ndëshkuar ky kamikazi Hamitaj, si në ndeshjen e parë. Me grupin e lojtarëve jam i kënaqur dhe nuk e besoj se jemi barazuar. E ka dhënë penalltinë një kamikaz tjetër, një Myrtja-Myrtja. Nuk ka kontroll topi te Guri. Na ka sakatuar me kartonë që në minutën e dytë për Siljanovskin. Na ndëshkon edhe për ndeshjen tjetër me mungesa. Ju them të gjithëve se ky arbitër gjykon Flamurtarin gjithmonë ndaj Kukësit dhe e ndëshkon. Kam parasysh ndeshjen e parë në Vlorë. Nëse është rastësi, ju kërktoj falje të gjithëve. Ka një rast penalltie, që mund ta çonte rezultatit në 0-2. Të dy gjyqtarët nuk dinin çfarë vendimi do të jepnin në rastin e golit tonë, nuk dinin çfarë do të bënin. Kjo është arsyeja që jam shumë i shqetësuar nga kjo ndeshje", u shpreh trajneri Duro pas ndeshjes në Kukës.

Mbyllen pa gola Lushnja-Luftëtari e Laçi-Teuta  
Page e bardhë në aksin Lushnjë-Laç




lueshme pas gjuajtjes së Shkurtajt. Sërish reagon shkëlqyeshëm gardiani lagunor ndaj Abazajt në kohën shtesë, duke i dhuruar një pikë shprese Luftëtarit. Laçi dhe Teuta e mbyllin gjithashtu me rrjeta të paprekura sfidën mes tyre. Në minutën

e 20-të Rexhinaldo i shkon shumë pranë golit për kurbinasit, por topi devijohet e del jashtë për fare pak, ndërsa në kohën shtesë të pjesës së parë, Selmani fluturon për të ndalur golin e durrsakëve. Në pjesën e dytë, Laçi i afrohet më shumë zonës kundër-

shitare, ndërsa në të 59'-ën Rexhinaldo nuk do të përfitojë nga një mosmarëveshje e Bilalit me Kastratin. Në të 71'-ën Uzuni i ka të gjitha mundësitë të kërcënojë, por do ta dorëzojë topin në duart e Kastratit. 6 minuta më pas përsëritet sërish dueli Uzuni-Kastrati dhe sërish gardiani durrsak ndal sulmuesin. Por nuk ka mbaruar me kaq. Minuta e 88-të dhe Uzuni ka të gjitha mundësitë të shënojë, por me këmbë do të ndalë Kastrati, që mban portën e paprekur, duke bërë që ekipet të ndajën nga një pikë.

**Fjalëkryqi (1)**



- 35. Qytet anglez.
- 36. Louis, poet surrealist.
- 38. Artet pa re.
- 39. Matet pa kufij.
- 40. Gruaja e Ben Hur.
- 42. Liam i Schindler's list.
- 45. Të parat në orkestër.
- 47. Makina Ibiza.
- 48. Renato, piktor i famshëm italian.
- 49. Mihali këngëtare lirike.

**VERTIKAL**

- 1. Mbyllin fushata.
- 2. Një pjesë e pikturave.
- 3. Janë njëvjeçarë
- 4. Një ngjyhet në tavolocë.
- 5. Eshhtë katolik ai i papës.
- 6. Mbyllin portat.
- 7. Opera e Mascagni-t.
- 8. Tregohet duke bërë masakra.
- 10. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- 11. Një gjuajtës francez.

**HORIZONTAL**

- 1. Me të nxjerrin një tapë.
- 4. Inicialet e Klee piktor.
- 6. Qiriaçi aktor.
- 9. Etikë pa kufij.
- 11. Merren për shembull.
- 14. Fund janari.
- 15. Janë edhe ata të skuadërës.
- 17. Ortolani kompozitor.
- 18. Ushtrohej edhe nga bukanierët.
- 20. Në krye të sondazheve.
- 21. Janë të ndaluar në kthesë.
- 23. Ente Rajonale Civile.
- 24. Gjermania në tabela.
- 25. Mund të jetë unik.
- 27. Philippe që që aktor.
- 29. Një pjesë e pelegrinazhit.
- 31. Gjysmë leader.
- 32. Maten pa zë.
- 33. Janë të përpjeta.

- 12. Eshhtë porti i Durrësit.
- 13. Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
- 16. Pak pirografi.
- 19. Një pjesë e aerobisë.
- 21. U vodhi zjarrin perëndive.
- 22. Premtojnë të bëhen asa.
- 23. Mbeten në fund.
- 26. Rreth pa ekstreme.
- 28. Rendi pa zë
- 29. Eshhtë veshje tahitianësh.
- 30. Tase e volejbollit.
- 33. Eshhtë shahu i fundit.
- 34. Kim... Stuart aktor.
- 35. Fritz regjisor.
- 37. Ai i shtatë është kinemaja.
- 39. Një pjesë e ansambliit.
- 41. Diftong teatral.
- 43. Të parat në stacion
- 44. Qendër në tour
- 46. Mbarojnë fare.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

- 1. Harris aktor.
- 3. Termocentrali i shkurtër.
- 5. Organizata me koska.
- 10. Një tuftë bagëtish.
- 12. Inicialet e Redford.
- 14. Kështu thonë se bëhet ai që mërziut.
- 15. Scarfet e Bashkë e erën.
- 17. Elvira aktore.
- 19. Eshhtë Panorama që ke në dorë.
- 21. Ushtojnë nga "ola".
- 22. Shtet aziatik.
- 24. Eshhtë ministri.
- 25. Në radhtë të parë.
- 26. G... për njerëzit e FBI.
- 27. Makina Micra.
- 31. Mund të jetë proteste.
- 32. Pasur pa kufij.
- 33. Gjika e Dora d'Istria.
- 36. Të fundit në dhjetor.


**VERTIKAL**

- 1. Umberto që shkroi Baudolino.
- 2. Bertë këngëtare italiane.
- 3. Fillojnë një temë.
- 4. Një garë në hipodrom.
- 6. Qe burri i parë.
- 7. Një ndriçues.
- 8. Bëjnë shirit me shi.
- 9. I dha fillin Tezeut.
- 10. Vihen për të mbyllur
- 11. Para Saint-Germain në futboll.
- 13. Qëllon në një vend.
- 16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
- 17. Janë përmasat.
- 18. Mbush në kufij.
- 20. I bëjnë duart me ar.
- 21. Inicialet e dali piktor.
- 23. Fillojnë argumentin.
- 28. Makina Ibiza.
- 29. Emri i Einstein.
- 30. Ndrriçojnë rrugët.
- 31. Kim që që aktore.
- 32. I hedh i dorzuar.
- 34. Inicialet e Nolte aktor.
- 35. Ishin rapsojëd e akejve.
- 37. Fund shkurti.
- 40. Van der portier holandez.
- 44. Fillojnë masat
- 46. Inicialet e Rohmer.
- 47. Fillojnë teorikisht.
- 49. Numër i shkurtër.




- 9. I dha fillin Tezeut.
- 10. Vihen për të mbyllur
- 11. Para Saint-Germain në futboll.
- 13. Qëllon në një vend.
- 16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
- 17. Janë përmasat.
- 18. Mbush në kufij.
- 20. I bëjnë duart me ar.
- 21. Inicialet e dali piktor.
- 23. Fillojnë argumentin.
- 28. Makina Ibiza.
- 29. Emri i Einstein.
- 30. Ndrriçojnë rrugët.
- 31. Kim që që aktore.
- 32. I hedh i dorzuar.
- 34. Inicialet e Nolte aktor.
- 35. Ishin rapsojëd e akejve.
- 37. Fund shkurti.
- 40. Van der portier holandez.
- 44. Fillojnë masat
- 46. Inicialet e Rohmer.
- 47. Fillojnë teorikisht.
- 49. Numër i shkurtër.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

	1	8			9			7
		2		8	5			3
5			3					1 4
6	4	9		1	8			
	3							2
			9	7		4	6	1
9	5				2			6
	6		5	4		7		
1			7			3	8	

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	6	5	9	2	3	8	7	1
3	8	1	7	6	4	5	9	2
7	2	9	1	5	8	3	6	4
5	7	6	3	4	1	2	8	9
9	3	4	2	8	5	7	1	6
8	1	2	6	9	7	4	5	3
6	4	7	8	3	9	1	2	5
2	5	8	4	1	6	9	3	7
1	9	3	5	7	2	6	4	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- "Vullneti është ai që të bën të fitosh atëherë kur logjika të thotë se ke humbur".  
**Carlos Castaneda**
- "Ashtu sikurse ata që ecin në diell ndiqen nga hija e tyre, kështu dhe ata që janë njerëz me vlera ndiqen nga lakmia e të tjerëve".  
**Sokrati**
- "Njeriu gjeni mund të qeshë me gjithçka, ndërsa njeriu logjik nuk mund të qeshë gati me asgjë".  
**Gëte**

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	P	U	6	S	1	I	15	2	3	5	7	3
2	4	8	4	7	8	6	9	1				
6	1	3	10	9	10	4	1	11	8	5		
12		3	8	11	7	4	8	13	8	5		
5	4	1	3	8	11	7	16	7	13	8		
10		3	8	5	8	5	1	11	8	5		
5	5	10	6	8	1	5	5	5	7	18		
1	8	4			3	4	8	11	1	13	10	
	4	1	17	12	8	10	4		6	1	9	
6	5	1	9	10	5		10		2	15	10	
4	2	16				8		2	15	10		
4	1	17	12	8	4	18			5	8		

**PËRÇJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

P	A	P	A	S	S	K	U	L	V	E		
A	R	A	D	M	I	N	A	T	E	G		
A	Z	O	E	D	I	S	O	N	E	B	R	O
A	R	A	T	N	T	A	S	M	A	N		
F	A	T	K	O	P	E	R	T	I	N	E	
I	T	M	A	T	E	R	I	A	L	E	S	
N	P	A	R	A	R	E	N	D	E	S	I	T
A	C	H	A	A	R	A	T	U	L	E	T	
C	H	A	A	R	A	T	U	L	E	T		
E	O	H	A	A	R	A	T	U	L	E	T	
C	L	I	N	T	I	L	U	L	I	T	E	K
K	A	P	A	C	I	T	E	T	R	O	M	E

**PËRÇJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

P	E	R	V	E	N	D	I	M	E	T		
A	Z	O	V	D	A	D	I	L	E	M	A	
K	O	M	E	D	I	M	I	L	A	N	E	Z
P	E	R	I	O	D	I	K	E	T	E		
T	I	S	A	M	A	R	I	T	A	N	E	T
J	K	A	M	E	R	A	M	A	N	E	V	
E	K	C	A	D	S	I	N	T	E	Z	A	
G	A	L	E	N	I	H	T	A	S	R		
U	L	E	T	B	I	B	E	R	O	N	I	
L	U	I	G	T	E	R	E	N	D	E		
L	A	K	E	M	A	R	A	I	S	E	T	
A	R	E	N	A	N	E	M	O	T	E		



*Ehënie të mençura*

- - Kur virtuti ka qenë i fjetur, ai zgjohet më i freskët. (Fridrih Nice)
- - Virtuti ashtu si ari që të jetë i përdorshëm, duhet të përziej me ndonjë metal tjetër me më pak vlerë, por më të fortë. (Samuel Batler)
- - Mos i besoni shkrimeve të vjetra, mos besoni asgjë vetëm se populli juaj i beson, ose sepse ju kanë detyruar t'i besoni që nga fëmijëria. Ndaj çdo gjëje veproni me arsye; pasi ta keni analizuar, nëse mendoni se është mirë për të gjithë, atëherë besojeni, jetojeni, dhe ndihmoni fqinjijn tuaj ta përjetojë edhe ai vetë.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!